

MODELE TË PLANIFIKIMEVE TË VEPRIMTARIVE TË SHKOLLAVE 9-VJEÇARE

**EDUKIMI PËR REDUKTIMIN E RREZIKUT TË DUKURIVE NATYRORE, MENAXHIMIN
E SITUATAVE EMERGJENTE DHE SIGURINË NË SHKOLLË**

**PLANIFIKIMI I VEPRIMTARIVE KROS DHE
EKSTRAKURRIKULARE**

Tiranë, 2019

1. Planifikimi i veprimtarive	3
2. Parimet dhe strategjitë gjithëpërfshirëse për një planifikim të suksesshëm	4
3. Procesi i hartimit të planit të veprimtarive	6
4. Planifikimi i veprimtarive kroskurrikulare	13
5. Realizimi i veprimtarive përmes kurrikulës me zgjedhje	15
6. Shembuj të veprimtarive në nivel shkolle /klase	17

1. PLANIFIKIMI I VEPRIMTARIVE

Krijimi i një kulture të qëndrueshme të sigurisë në shkollë dhe zhvillimi i nxënësve të kompetencave të nevojshme për të njohur, parandaluar dhe menaxhuar rreziqet e ndryshme që mund të krijohen për shkak të dukurive natyrore apo të shkaktuara nga faktorë të tjerë, është një ndër përgjegjësitë e shkollës që lidhet me rolin e saj edukues dhe arsimor.

Nëse shkollat janë të përgatitura, jovetëm janë në gjendje të menaxhojnë situatën brenda tyre, por mund të shërbejnë dhe si qendra ndërgjegjësuese për prindërit dhe komunitetin e afërt.

Edukimi i vazhdueshëm i nxënësve për njohjen, parandalimin dhe menaxhimin e rreziqeve natyrore ose nga faktorë të tjerë, sikurse përgatitja e stafit të shkollës duhet të jenë një proces i mirëplanifikuar.

Këtij qëllimi i shërben planifikimi i veprimtarive për edukimin për menaxhimin e rrezikut të fatkeqësive natyrore ose civile dhe situatave emergjente në shkollë.

Veprimtaritë që shkolla planifikon me këtë fokus mund të përfshihen në një plan të veçantë ose të integrohen në plane të tjera, si p.sh plani i shkollës si qendër komunitare etj, në varësi të tematikave të veprimtarive, formës kroskurrikulare ose ekstrakurrikulare të përfshirjes së tyre, si dhe në varësi të aktorëve që marrin pjesë për realizimin e tyre.

Planifikimi i veprimtarive duhet të kryhet në përmbushje dhe duke respektuar nenet përkatëse për sigurinë në Dispozitat Normative. Shkolla është përgjegjëse për sigurinë e nxënësve dhe anëtarëve të stafit mësimor. Ajo nuk duhet të ndërmarrë veprimtari që vendosin në rrezik sigurinë e nxënësve dhe stafit.

2. PARIMET DHE STRATEGJITË GJITHËPËRFSHIRËSE PËR NJË PLANIFIKIM TË SUKSESSHËM

Procesi i planifikimit të veprimtarive duhet të jetë përshkallëzues me synim:

- ✓ ndërgjegjësimin e komunitetit të shkollës;
- ✓ zhvillimin e kapaciteteve për parandalimin, mbrojtjen, menaxhimin e situatave emergjente dhe zbutjen e pasojave, si dhe
- ✓ krijimin e një kulture bashkëpunimi dhe solidariteti të nxënësve, mësuesve dhe pjesës tjetër të stafit mësimor, prindërve dhe anëtarëve të tjerë të komunitetit.

Gjatë punës për konceptimin, hartimin dhe zbatimin e veprimtarive është e rëndësishme të respektohen nenet të mbahen parasysh parimet e mëposhtme:

QARTËSIA DHE FLEKSIBILITETI

- Në planifikimet e veprimtarive duhet të jenë të përcaktuara qartë rolet dhe përgjegjësitë e aktorëve që marrin pjesë në zhvillimin e veprimtarive.
- Plani i veprimtarive duhet të jetë një plan fleksibël. Ai duhet t'i krijojë mundësi shkollave për përfshirjen e veprimtarive në varësi të situatave dhe nevojave.

PËRGJEGJËSITË, GJITHËPËRFSHIRJA DHE KONSULTIMI

- Veprimtaritë e planifikuara duhet të përshkruajnë qëllimin dhe të përcaktojnë përgjegjësitë dhe kufizimet.
- Veprimtaritë që zhvillohen me nxënësit duhet të jenë në përshtatje me grupmoshën e tyre.

- Planifikimi i veprimtarive, i cili koordinohet nga komisioni i sigurisë në shkollë dhe drejtoria e shkollës, duhet të jetë produkt i proceseve konsultese me anëtarë dhe partnerë të komunitetit të shkollës, sikurse me përfaqësues të DAR/ZA. Është shumë e rëndësishme që kur hartohet plani i veprimtarive i kushtohet rëndësi e veçantë gjetjes së strategjive të përshtatshme për të tërhequr sa më shumë aktorë të komunitetit për zbatimin e planit dhe për realizimin e veprimtarive të parashikuara në të.
- Angazhimi i aktorëve të ndryshëm në zbatimin e veprimtarive do të jetë më i madh kur ato do të përfshihen në planifikimin e tyre.

SHPËRNDARJA E PLANIT

- Të gjithë anëtarët e komunitetit të shkollës duhet të jenë të familjarizuar me përmbajtjen e planit.
- Përveçse me aktorët brenda shkollës (nxënësit, mësuesit dhe drejtuesit e shkollës, anëtarë të tjerë të stafit mësimor si psikologu, punonjësi social, infermierja apo mjekja e shkollës), plani duhet shpërndarë dhe me prindërit e nxënësve në mënyrë që ato të informohen për veprimtaritë që shkolla ka planifikuar.
- Veprimtaritë e planifikuara mund të ekspozohen në një vend të posaçëm në Këndin e sigurisë në shkollë.

PËRDITËSIMI

- Plani i veprimtarive për sigurinë në shkollë dhe menaxhimin e emergjencave duhet rishikuar rregullisht.
- Mirë do të ishte që ky proces të zhvillohej të paktën një herë në vit, në mënyrë të veçantë pas një situatë emergjence, për të siguruar që plani është funksional.

BASHKËPUNIMI DHE KOORDINIMI

- Veprimtaritë që përfshin plani dhe realizimi i tyre kërkojnë që shkolla të zhvillojë bashkëpunime me organizma dhe institucione të cilat mund të kontribuojnë për zhvillimin e tyre. Të tilla institucione mund të jenë pushteti vendor, autoriteti për emergjencat, qendrat shëndetësore, zjarrfikësja, policia, Kryqi u

kuq etj., të cilat kanë ekspertizën profesionale dhe autoritetin përgjegjës për menaxhimin e situatave të ndryshme. Gjithashtu, shkolla mund të krijojë bashkëpunime dhe partneritete me organizata që kanë kontribute në këtë fushë, sikurse dhe me individë me ekspertizë në këtë fushë.

- Në raste të tilla plani i shkollës duhet koordinuar me planin e tyre të veprimtarive.

KOHERENCA

- Planin e veprimtarive të shkollës duhet të jetë në koherencë me planin e përgjithshëm të veprimtarive në nivel DAR/ZA.

3. PROCESI I HARTIMIT TË PLANIT TË VEPRIMTARIVE

Çdo shkollë, pasi ka kryer një vlerësim të nevojave dhe burimeve të vlefshme që ka, mund të zhvillojë planin e saj të veprimtarive i cili nuk mund të ngjajë me atë të një shkolle tjetër për arsye të specifikave që shkollat kanë (lidhur me rreziqet më të mundshme, nevojat prioritare, burimet e vlefshme).

- Planifikimi i veprimtarive duhet të jetë i orientuar nga rezultatet. Për këtë qëllim plani duhet të përcaktojë qartë objektivat e tij.
- Planin duhet të përcaktojë qartë veprimtaritë për përmbushjen e objektivave. Veprimtaritë që zhvillohen me nxënësit duhet të jenë në përshtatje me grupmoshën e tyre dhe nuk duhet të vendosin në rrezik sigurinë e tyre dhe stafit të shkollës.
- Planin përcakton qartë cilët janë personat përgjegjës për zhvillimin e veprimtarive.

- Plani përshkruan për secilën prej veprimtarive partnerët dhe bashkëpunëtorët që angazhohen për zhvillimin e veprimtarive.
- Plani përcakton afatet për realizimin e veprimtarive.
- Në plan përcaktohen për secilën veprimtari burimet e vlefshme materiale që mundësojnë realizimin e veprimtarive (opsionale).

SHEMBULL PLANIFIKIMI I VEPRIMTARIVE KROS DHE EKSTRAKURRIKULARE ME FOKUS

Edukimi për reduktimin e rrezikut të fatkeqësive natyrore, menaxhimin e situatave emergjente dhe sigurinë në shkollë

Nr.	Objektivat	Veprimtaritë/ Nënveprimtaritë	Periudha e zbatimit	Personat përgjegjës dhe anëtarët e grupit të punës	Partnerët/ Bashkëpunime
I.	<p>Planifikimi i veprimtarive në nivel klase/shkolle për njohjen, parandalimin dhe</p>	<p>1. Identifikimi i fushave prioritare të veprimtarive:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Tryeza të rrumbullakta me mësues për identifikimin e hapësirave kros 	<p>Muaji Shtator (Java e tretë)</p>	<p>Stafi drejtues i shkollës</p> <p>Komisioni i sigurisë në shkollë</p>	<p>Prindër (Përfaqësues të Këshillave të prindërve)</p> <p>Nxënës (Përfaqësues të</p>

menaxhimin e rreziqeve natyrore ose nga faktorë të tjerë	<p>dhe ekstra për përfshirjen e veprimtarive.</p> <ul style="list-style-type: none">- Pyetësorë me nxënës, mësues, prindër për vlerësimin e nevojave dhe burimeve të shkollës. <ol style="list-style-type: none">2. Përgatitja e planit të veprimtarive kros dhe ekstrakurrikulare, në nivel klase/shkollë.3. Ngritja dhe pasurimi i këndit të sigurisë në shkollë (Afishimi i	<p>Muaji Shtator (Java e tretë)</p> <p>Muaji Shtator (Java e katërt)</p>	<p>Qeverisë së Nxënësve) Drejtoria Arsimore Rajonale Pushteti lokal</p>
---	---	--	---

		numrave të emergjencave, shpallja e veprimtarive të planifikuara, foto të veprimtarive, rregullorja e sigurisë etj).	Muaji Shtator (Java e katërt dhe në vazhdimësi përgjatë vitit shkollor)		
II.	Ndërgjegjësimi i komunitetit të shkollës për përgatitjen për	1. Veprimtari ndërgjegjësuëse në nivel shkolle me rastin e 13 Tetorit-	13 Tetor	Stafi drejtues i shkollës Komisioni i sigurisë	Komuniteti i shkollës Prindër

	<p>për rrezikun ndaj fatkeqësive natyrore dhe menaxhimin e situatave emergjente</p>	<p>Ditës ndërkombëtare të reduktimit të rrezikut ndaj fatkeqësive natyrore:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përgatitje e posterave/fletëpalosjeve. - Prezantime nga ekspertë të mjedisit ose të autoritetit të emergjencave për rëndësinë e përgatitjes për reduktimin e rrezikut të fatkeqësive natyrore. 		<p>Qeveria e nxënësve</p> <p>Mësues</p>	<p>Specialistë të mjedisit ose të autoritetit të emergjencave</p>
--	--	---	--	---	---

III. Përgatitja dhe aftësimi i komunitetit të shkollës për njohjen, parandalimin dhe menaxhimin e situatave emergjente	2. Orë mësimore model – Veprimtari kroskurrikulare në lëndën e gjeografisë për tërmetet, masat që merren për mbrojtjen ndaj tyre dhe procedurat e veprimit në rast tërmeti.	Dhjetor (Java e parë)	Mësues të gjeografisë dhe nxënësit e klasave të 7-ta	I ftuar një sizmiolog ose një përfaqësues i autoritetit të emergjencave
	2. Veprimtari – Simulimi i dhënies së ndihmës së shpejtë në rast të një situatave emergjente.	Shkurt (Java e dytë)	Nxënës të klasave të 9-ta Mësues të Edukimit fizik dhe Biologjisë	Anëtarë të tjerë të stafit mësimor (mësues, psikolog, punonjës social) I ftuar një përfaqësues i Kryqit të Kuq

		3. Orë edukative – Diskutim: Rëndësia e njohjes dhe zbatimit të rregullave të sigurisë në shkollë.	Mars (Java e parë)	Mësuesit kujdestarë Nxënësit e shkollës	

4. PLANIFIKIMI I VEPRIMTARIVE KROSKURRIKULARE

Edukimi për reduktimin e rreziqeve nga fenomenet natyrore, faktorë të tjerë dhe menaxhimin e situatave emergjente është një nga fushat për të cilën mësuesit duhet të kujdesen lidhur me planifikimin dhe përfshirjen e veprimtarive në procesin e mësimdhënies dhe të nxënies. Ndërgjegjësimi i nxënësve për rolin që luajnë

individët dhe shoqëritë në reduktimin e rreziqeve nga fenomenet natyrore dhe parandalimin e shumë prej situatave, është shumë e rëndësishme. Kjo jep mundësi për të krijuar aftësi të caktuara të nxënësit lidhur me parandalimin, përgatitjen e tyre për menaxhimin e emergjencave natyrore dhe civile, si dhe përballimin e pasojave të tyre. Këto veprimtari ndihmojnë shkollën për zhvillimin e një kulture të qëndrueshme të sigurisë në shkollë dhe zhvillimin e aftësive për jetën të nevojshme për të parandaluar dhe menaxhuar rreziqet e ndryshme që mund të krijohen për shkak të dukurive natyrore apo të shkaktuara nga faktorë njerëzorë.

Pyetja apo dilema që mund të mundojë mësuesin që kërkon të përfshijë veprimtari të tilla në kurrikulën e klasës ku ai zhvillon mësim, është “Ku dhe kur do të zhvilloj veprimtari që lidhen me këto çështje”. Kurrikula e arsimit bazë në lëndë të ndryshme si gjeografi, biologji, qytetari, aftësim teknologjik, kimi etj, ka krijuar hapësira të cilat i japin mundësi mësuesit të vendosë vetë për aktivitetet që do të zhvillojë me nxënësit e tij në përmbushje të tematikave dhe rezultateteve të të nxënësve. Mësuesit e lëndëve të ndryshme është mirë që kur përgatisin planin vjetor lëndor për një klasë të caktuar, të shënojnë me një simbol të dhënë, p.sh një yll, një rreth etj., ato tema mësimore në të cilat ka mundësi të përfshihen në mënyrë të natyrshme çështje që lidhen me fatkeqësitë natyrore dhe rreziqet që vijnë prej tyre, rreziqet që vijnë si pasojë e veprimtarisë njerëzore etj., duke bërë të mundur që kjo fushë edukimi të mos i lihet spontanitetit.

Më poshtë janë dhënë dy shembuj veprimtarish:

Shembull 1

Në lëndën e Gjeografisë në klasën e 7-të, në temat që lidhen me tërmetet, lumenjtë dhe veprimtarinë e tyre, rrëshqitjet e dherave, ndryshimet klimatike etj, mësuesi mund të zhvillojë me nxënësit diskutime për dëmet që sjellin tërmetet, masat për mbrojtjen ndaj tyre, përfshirë veprimet për mbrojtjen në një rast tërmeti; ndikimin e veprimtarisë së njeriut në pakësimin ose shtimin e rreziqeve të disa prej situatave emergjente si p.sh., dalja e lumenjve nga shtrati dhe përmbytjet, rrëshqitjet e dherave etj.

Shembull 2

Një shembull tjetër mund të jetë rasti i kurrikulës së edukimit fizik përmes së cilës nxënësit mësojnë për dhënien e ndihmës së parë, mënyrën e veprimit në raste të ndryshme (p.sh., rrëshqitje/rrëzim, humbje e ndjenjave etj) duke e shoqëruar me demonstrime nga nxënësit.

5. REALIZIMI I VEPRIMTARIVE PËRMES KURRIKULËS ME ZGJEDHJE

Një nga hapësirat lehtësisht të mundshme të përfshirjes së veprimtarive për sigurinë në shkollë është dhe hapësira e kurrikulës me zgjedhje. Kurrikula me zgjedhje ka një hapësirë kohore të përcaktuar qartë në planin

mësimor të të gjitha klasave të arsimit bazë (1 orë mësimore në javë për klasat 1-3, dhe 2 orë mësimore në javë për klasat 4-9).

Në fillim të vitit shkollor, një nga momentet më të rëndësishme të punës së mësuesit, është planifikimi vjetor i veprimtarive dhe planifikimi i secilës periudhë në veçanti. Kjo do të thotë që në fillim të vitit shkollor mësuesit i duhet të planifikojë temat dhe rezultatet e të nxënësve që do të zhvillohen me nxënësit në klasën e tij.

Mësuesi mund të planifikojë që në fillim të vitit, një numër të caktuar veprimtarish që i takojnë çështjeve të sigurisë dhe menaxhimit të emergjencave për një periudhë të caktuar ose të zhvillonte një planifikim të veprimtarive me shtrirje gjithëvjetore.

Model i një planifikimi vjetor të kurrikulës me zgjedhje, klasa e 8-të

Tematika vjetore: Siguria në shkollë

<i>Periudha e parë</i>	Siguria në shkollë: Edukimi për një të ushqyer të shëndetshëm	25 orë
<i>Periudha e dytë</i>	Siguria në shkollë: Edukimi për menaxhimin e emergjencave	25 orë
<i>Periudha e tretë</i>	Siguria në shkollë: Edukimi rrugor	20 orë

Sikurse e tregon shembulli i mësipërm i planifikimit të kurrikulës me zgjedhje, mësuesi mund të zhvillojë tematikën e sigurisë në shkollë me shtrirje gjithë vjetore, duke e organizuar këtë tematikë në tri module të cilët zhvillohen përgjatë tri periudhave:

- Moduli 1: Edukimi për një të ushqyer të shëndetshëm
- Moduli 2: Edukimi për menaxhimin e emergjencave
- Moduli 3: Edukimi rrugor

6. SHEMBUJ TË VEPRIMTARIVE NË NIVEL SHKOLLE /KLASE

Veprimtari: Lojë në role - Rreziku ndaj fatkeqësive natyrore

Grupmosha: Nxënësit e klasave të 7-ta, 8-ta, 9-ta

Koha e nevojshme: 45 minuta

Materialet e nevojshme:

- Një kartë 'A' dhe një kartë 'B' për secilin grup nxënësish

- Organizimi i klasës në mënyrë të tillë që nxënësit të ndarë në grupe të jenë përballë njëri-tjetrit. Nxënësit zbulojnë vështirësitë dhe dilemat që hasin autoritetet publike kur ndërmarrin masa për zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë natyrore.

Proçedura:

Hapi 1: Kërkojuni nxënësve, të ulur në çifte, të zgjedhin të jenë 'A' ose 'B'. Jepini të gjithëve një kartë 'A' ose 'B' nga i njëjti grup. Kërkojuni atyre të lexojnë kartën e tyre disa herë dhe të mendojnë për çështjen e përfshirë.

Hapi 2: Kërkojuni grupeve të çifteve të hyjnë në rol për të diskutuar dhe për të argumentuar çështjet që kanë të bëjnë me “konfliktin” midis tyre.

Hapi 3: Përfundojeni lojën me role dhe kërkojuni klasës të diskutojë çështjet e ngritura, dilemat e paraqitura dhe çdo përfundim që u arrit.

Hapi 4: Përsëriteni procesin, duke përdorur një grup të dytë kartash.

Sugjerime:

- Ftoni një përfaqësues të pushtetit lokal në klasë për ta pyetur se si merren vendimet kur ka përplasje interesi midis asaj që quhet "e mira e përbashkët" dhe asaj që individi e interpreton si e mirë e tyre.
- Shkruani skenarët tuaj duke përdorur shembuj realë.

Përfshirja në kurrikulën mësimore:

Ky aktivitet mund të integrohet me veprimtari mësimore të lëndëve të fushës Shoqëria dhe mjedisi, në mënyrë të veçantë në lëndën e Gjeografisë, Qytetarisë dhe mund të përdoret gjithashtu brenda mësimëve të lëndës së Teatrit.

Situatat e rastit

Reduktimi i rrezikut të katastrofave dhe masat e ndërmarra mbi ndryshimet klimatike do të nxisin gjithnjë e më shumë debate të tilla.

	Karta A	Karta B
Skenari 1	Ju jeni një përfaqësues i qeverisjes vendore i ngarkuar me njoftimin e anëtarëve të një komuniteti që ka ndërtuar shtëpitë pranë bregut të lumit, se është marrë vendimi që shtëpitë e tyre të shemben, sepse lumi po del nga shtrati gjithnjë e më shpesh dhe po bëhet një rrezik fatkeqësie për komunitetin. Ju jeni të përgatitur për të	Ju jetoni në një komunitet që gjendet pranë bregut të lumit. Familjet kanë jetuar në shtëpitë e tyre për breza. Ju jeni në pritje të ardhjes së një përfaqësuesi të qeverisjes vendore që po vjen t'ju informojë për vendimet e marra për komunitetin tuaj, duke qenë se lumi po del nga shtrati më shpesh. Ju padyshim nuk doni ta shihni komunitetin tuaj në rrezik!

	diskutuar për ndihmën për zhvendosjen e komunitetit.	
Skenari 2	<p style="text-align: center;">Karta A</p> <p>Është viti 2050. Ju jeni një përfaqësues i qeverisjes vendore. Niveli i detit është rritur aq shumë sa ka përmbytje të bregut të zonës. Për t'i ndaluar përmbytjet dhe për të mbrojtur bujqësinë dhe komunitetet që banojnë aty qeveria ka vendosur të ndërtojë mure detare në disa nga plazhet më të dashura në atë zonë. Detyra juaj është të shpjegoni dhe të justifikoni vendimin tek pronarët e hoteleve pranë plazheve në fjalë.</p>	<p style="text-align: center;">Karta B</p> <p>Ju keni një hotel të madh që për dekada ka qenë një tërheqje e madhe për turistët nga e gjithë bota që dëshirojnë diellin, detin dhe palmat. Plazhi aty pranë është vendimtar për të ardhurat tuaja. Ju keni dëgjuar për planet e qeverisë për të ndërtuar një mur në detin përgjatë plazhit. Ju besoni se kjo do të largojë turistët dhe burimin e të ardhurave tuaja. Një përfaqësues i qeverisjes vendore do t'ju vizitojë për të shpjeguar situatën.</p>

MODELE TË PLANIFIKIMEVE TË VEPRIMTARIVE

PLAN I VEPRIMTARIVE

“EDUKIMI PËR MENAXHIMIN E EMERGJENCAVE DHE SIGURINË NË SHKOLLË” SHKOLLA 9-VJEÇARE “NAUM VEQILHARXHI”, KORÇË

OBJEKTIVAT:

1. Të gjithë aktorët, të njihen me nevojat e shkollës sonë.
2. Të formojnë njohuri në dhënien e ndihmës së parë në rast emergjence.
3. Të jenë të organizuar dhe të denjë në rast emergjence dhe menaxhimin e situatës.

PLANI I VEPRIMTARIVE:

NR	OBJEKTIVAT	VEPRIMTARIA	PERIUDHA	PERSONAT PËRGJEGJËS	PARTNERË, BASHKËPUNUES
1	Të bëhet një përcaktim i nevojave	Takim me specialist, inxhinierë, përfaqësues të	Shkurt 2019	Mësues, nxënës, prindër, anët.komuniteti	Qark, Bashki, QMBSH, DAR, etj.

	të veçanta që shkolla ofron.	Qarkut, QMBSH, bashkisë për përcaktimin e nevojave që shkolla ofron.		përfaqësues të ndryshëm.	
2	Të njihën dhe të formojnë njohuri në dhënie e ndihmës së parë në rast emergjence.	-Takim të një grupi nxënësish (Dy nxënës për klasë), të shoqëruar me mës. R.Stefa, me anëtarë të Kryqit të Kuq. -Ditën e Premte, dy nxënësit bëjnë demonstrime në klasë gjatë Orës Edukative.	-20.02.2019 -22.02.2019	Mësues, nxënës, prindër, anët.komuniteti përfaqësues të ndryshëm.	Mësues, anëtarë komuniteti, Kryqi i Kuq Shqiptar.
3	Të jenë të organizuar dhe të denjë në rast emergjence dhe	Stimulimi i një rasti emergjence (zjarri) dhe menaxhimi i situatës.	Mars-Prill 2019	Mësues, nxënës, prindër, anët.komuniteti	Mësues, nxënës, antërë të komunitetit, Kryqi I Kuq, Shërbimi

	menaxhimin e situatës			përfaqësues të ndryshëm.	Zjarrëfikës, Policia, Urgjenca.
4	Të realizohet raporti përmbledhës nëpërmjet prezantimit të një projekt- aktiviteti.	Prezantimi I projektit nëpërmjet materialeve përmbledhëse.	Maj 2019	Mësues, nxënës, prindër.	Mësues, nxënës, prindër, anët.komuniteti përfaqësues të ndryshëm.

PLAN I VEPRIMTARIVE
“EDUKIMI PËR MENAXHIMIN E EMERGJENCAVE DHE SIGURINË NË SHKOLLË”
SHKOLLA E MESME E BASHKUAR “AJET XHINDOLE”, BERAT

PROFILI I SHKOLLËS

Emri i shkollës	Ajet Xhindole
Adresa e shkollës	Lagjja Muzakaj
Sipërfaqja e ndërtesës së shkollës	1200
Sipërfaqja e shkollës bashkë me oborrin	1580
Vjetërsia e ndërtesës (në vite)	37
Periudha e rindërtimit (në vite)	Rindertim 2004
Numri i daljeve Dalje kryesore: Dalje emergjence:	Vetëm dalje kryesore Nuk ka dalje emergjence

Kapaciteti i projektuar i shkollës (në nr. nxënësish)	600
Numri total nxënësve	503
Kati i 1-rë:	290
Kati i 2-të:	190
Kati i 3-të:	23
Numri total i stafit	
Gjithsej:	67
Staf pedagogjik	60
Staf administrativ	2

Planimetria e shkollës

Bashkëngjitur gjendet një kopje e planimetrisë së ndërtesës së shkollës, i cili përfshin të gjithë ndërtesën dhe planimetrinë e çdo kati.

Ky plan do të përdoret për vlerësimin e sigurisë dhe për përgatitjen e një plani evakuimi.

HARTA E ZONËS NË TË CILËN ËSHTË VENDOSUR SHKOLLA

Bashkëngjitur gjendet një kopje e hartës së zonës në të cilën është vendosur shkolla. Kjo hartë do të përdoret për vlerësimin e sigurisë.

KONTAKTET PËR RASTET E EMERGJENCAVE

Pozicioni	Emri	Kontakti
Administrata e shkollës		
Drejtori	Arben Qafa	0696567838
Koordinatori për emergjencat	Tefta Zogaj	068451926
Autoritetet lokale		
Shërbimet e emergjencave		
Zjarrfikësja		128
Policia		129
Policia rrugore		126
Ambulanca		127

Shërbimet e tjera, Kryqi i Kuq	Ilva	0692202855
--------------------------------	------	------------

KOMISIONI I MENAXHIMIT TË EMERGJENCAVE

Nr	Pozicioni	Emri	Kontakt
1	Kryetar i komisionit	Arben Qafa - drejtor	0696567838
2	Përfaqësues i nxënësve	Vasikl Tapia	0692563651
3	Përfaqësues i prindërve	Llambrini Mance	0692256898
4	Kryetar i ekipit për mbrojtjen nga zjarri	Tefta Zogaj	068451926
5	Kryetar i ekipit për ndihmën e parë dhe mbështetjen psiko-sociale	Albana Ismaili	0698525835

Nr	A.Fatkeqësi a	B.Propabilit eti	C.Vulnerabil iteti/Impak ti	D.Përqindja e rrezikut	E.Niveli i rrezikut	F.Prioriteti
		1=Shumë e ulët - 5 = E lartë	1.E parëndësishme - 5 Katastrofike	BxC	Sh e ulët- sh e lartë	E ulët- e lartë
1	Zjarr	4	5	20		Shumë e lartë
2	Tërmet	4	5	20		Shumë e lartë
3	Përmbytje	1	2	2		E ulët
4	Rrëshqitje toke	4	4	16		E lartë
5	Mungesë uji (thatësirë)	3	3	9		Mesatare

6	Ndotja për shkak të një fabrike kimike	1	2	2		E ulët
---	--	---	---	---	--	--------

Nr	Veprimtaria	Afati	Personat përgjegjës	Burimet	Bashkëpunimet
1	Krijimi i Komisionit të Menaxhimit të Emergjencave	Shtator	Drejtoria	Dispozitat Normative Burimet njerëzore	
2	Vlerësimi i vulnerabilitetit	Tetor	Drejtoria, Komisioni i Menaxhimit të Emergjencave	Burime njerëzore dhe Burime proceduriale	Inxhinierja pranë DAR Berat, Inspektori pranë Drejtorisë së Arsimit Bashkia Berat
3	Hartimi i planit vjetor	Tetor	Drejtoria, Komisioni i Menaxhimit të Emergjencave	Burime njerëzore brenda shkollës	
4	Hartimi i një rregulloreje Nxënësit të përgatisin së bashku me prindërit një rregullore ku të kërkohet të shkruajnë 10 rregulla	Nëntor	Prindër e nxënës	Burime njerëzore Brenda dhe Jashtë shkollës	Prindërit

	për sigurinë që janë më të rëndësishmet e tyre për mbrojtjen e familjes nga rreziqe të ndryshme. Këto fletë me rregulla të vendosen më pas në këndin e klasës/ shkollës.				
5	<p>Ndërgjegjësimi i nxënësve, prindërve dhe mësuesve rreth procedurave standarde në rast fatkeqësie</p> <p>Shpërndarje e materialeve të ndryshme që kanë lidhje me sigurinë. Informimi mbi rëndësinë e ndjekjes së rregullave apo zbatimit të masave mbrojtëse për një rrezik të caktuar si zjarri, drejtimi i makinës, ecja në rrugë të vështira, përmytja etj.</p>	Tetor- Nëntor- Dhjetor	Komisioni- Psikologe- Infermiere e shkollës	Videoprojektorë Material word, Fletëpalosje,	Përfaqësues nga komisioni i menaxhimit të emergjencave

6	Ftesë ekspertëve të ndryshëm (ekspertë të emergjencave civile, zjarrfikësve, policisë, meteorologë, përfaqësues të Kryqit të Kuq, arkitektë, individë me aftësi të kufizuar, përfaqësues të organizatave të ndryshme, persona që kanë përjetuar fatkeqësi natyrore ose të tjera) në projekte ose orë mësimore apo edukative të veçanta me temë sigurinë.	Gjatë gjithë vitit shkollor	Drejtoria, Komisioni i Menaxhimit të Emergjencave	Harta të ndryshme, mjete kundër zjarrit, postera etj.	Ekspertë nga shërbime, organizata e individë të vecantë.
7	Trajnim i një grupi mësuesish për MKZ dhe demonstrim i veprimeve në rast zjarri	Dhjetor-Mars	Drejtoria	Pajisjet për mbrojtjen kundër zjarrit	Punonjës të Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi SHMZSH
8	Veprimtari me senatin e shkollës për krijimin e grupeve të patronazhit për nxënësit vulnerabël dhe me aftësi ndryshe	Janar	Mësuesja koordinatore e senatit, Psikologjia, Senati i shkollës	Burime njerëzore	

9	<p>Një histori për Sigurinë. Biseda me persona nga komuniteti qe të ndajnë një eksperiencë personale me fëmijët lidhur me një çështje të caktuar për sigurinë. Të tillë mund të jenë persona të cilët kanë një histori dhe eksperiencë e cila thekson rëndësinë e ndjekjes së rregullave apo zbatimit të masave mbojtëse për një rrezik të caktuar si zjarri, drejtimi i makinës, ecja në rrugë të vështira, përmbytja etj.</p>	Janar	Drejtoria	Burime njerëzore	Të ftuar nga komuniteti
10	<p>Takim me prindërit Eksplorim i mënyrave se si të mësuarit për reduktimin e rrezikut të emergjencave mund të mbështetet nga familja dhe komuniteti.</p>	Shkurt	Drejtoria, Komisioni i Menaxhimit të Emergjencave	Burime njerëzore	Ekspertë nga radhët e prindërve të nxënësve të shkollës

11	Simulime evakuimi në rang klase në mënyrë që të përgatiten nxënësit dhe stafi.	Gjatë gjithë vitit	Mësuesit kujdestarë	Anëtarë të Komisionit në shkollë	Komisioni i Menaxhimit të Emergjencave
12	Aktivitet me nxënës Nxënësit përgatisin postera e fletëpalosje për rreziqet dhe veprimet në rastet e fatkeqësive natyrore ose emergjencave civile	Mars	Mësuesit e artit figurativ	Kartona, lapustila, lapsa, ngjyra etj...	Drejtoria
13	Vendosje e posterave në shkollë me tematikën e sigurisë	Mars	Nxënësit, Senati	Kartona, lapustila, lapsa, ngjyra etj...	Drejtoria
14	Simulim me nxënësit dhe stafin për njohjen dhe zbatimin e procedurave standarde të veprimit në rast emergjencash dhe fatkeqësish të ndryshme.	Prill	Nxënës, mësues, staf administrativ		
15	Ese/tregim të shkurtër për një çështje të sigurisë. Konsulta me mësuesit dhe prindërit apo anëtarët e tjerë	Gjatë gjithë muajit prill	Nxënës prindër mësues kujdestar	Formate A4, lapsa, stilolapsa	

	<p>të familjes, një rast ku ata janë përballur me një rrezik të caktuar dhe prinderit të sugjerojnë se cilat elemente të sigurisë janë neglizhuar apo rasti i kundërt që mund t'i kenë shpëtuar ata. Këtu përfshihen situata të hasura në punën e prindërve si psh rastet e mos përdorimit të mjeteve mbrojtëse në punë, drejtimi i automjetit duke mos zbatuar rregullat e qarkullimit, mos respektimi i rregullave dhe masave mbrojtëse në punët në bujqësi etj. Këto punime të paraqiten para klasës dhe të votohet tregimi më i mirë.</p>				
16	<p>Organizimi i Ditës së Sigurisë Konkursi i Artit për Sigurinë</p>	2-5 Maj	Nxënës Mësues Mësues të Artit Figurativ	Burime njerëzore dhe materiale	

	<p>Motivimi i nxënësve shpërndarje e certifikatave.</p> <p>Nxënësit e një klase/ disa klasave apo shkollës të ftohen të shprehin në një formë të caktuar artistike mendimet e tyre për sigurinë dhe rëndësinë që ajo ka në jetën e njeriut. Të tilla mund të jenë shkrimi i poezive, realizimi i vizatimeve, përgatitje e fjalëkryqeve, realizimi i një skeçi me disa nxënës, punime në plastelinë, etj.</p> <p>dhe ti ekspozojnë këto punime arti në mënyrë që të jenë të vizitueshme nga publiku i gjerë i zonës.</p>				
--	--	--	--	--	--

PLAN I VEPRIMTARIVE
“EDUKIMI PËR MENAXHIMIN E EMERGJENCAVE DHE SIGURINË NË SHKOLLË”
SHKOLLA 9-VJEÇARE “GJERGJ FISHTA”, LEZHË

Synimi

Plani i menaxhimit të rrezikut të emergjencave synon:

- Reduktimin e rrezikut të fatkeqësive dhe emergjencave në shkollë dhe zonën pranë saj;
- Menaxhimin e shpejtë dhe eficient të situatës emergjente në shkollë;
- Sigurimin pa ndërprerje dhe në mënyrë të vazhdueshme të procesit mësimor dhe edukues.

Objektivat

Objektivat e planit të menaxhimit, të reduktimit të rrezikut, të fatkeqësive dhe emergjencave janë:

- Hartimi dhe zhvillimi i një sistemi të menaxhimit të rrezikut të emergjencave në shkollë;
- Identifikimi i fatkeqësive natyrore të mundshme dhe i rasteve të fatkeqësive të shkaktuara nga njeriu në shkollë dhe zonën përreth saj;
- Vlerësimi i vulnerabilitetit dhe kapaciteteve të shkollës;
- Zhvillimi i veprimtarive përgatitore për reduktimin e rrezikut të fatkeqësive dhe emergjencave;
- Zhvillimi i një kulture të sigurisë dhe e qëndrueshmërisë ndërmjet nxënësve, mësuesve, drejtuesve dhe aktorëve të tjerë në shkollë, përmes zhvillimit të njohurive, inovacionit dhe edukimit;

- Zhvillimi i veprimtarive për zbutjen e pasojave të emergjencave, të cilat përfshijnë sigurimin e jetës dhe reduktimin e dëmtimeve, mbrojtjen e pronës dhe materialet e tjera të shkollës.

Nr	Veprimtaria	Personat përgjegjës	Afati	Burimet e nevojshme
1.	Takim i komisionit të menaxhimit të emergjencave dhe sigurisë në shkollë. - Ndarja e detyrave.	Drejtorja e shkollës.	Shtator	Dispozitat Normative
2.	Tryezë e rrumbullakët me qeverinë e nxënësve. - Llojet e emergjencave në shkollë.	Komisioni i emergjencave	Tetor	Udhëzuesi për shkollat 9-vjeçare
3.	Njohja me përfaqësuesit e shërbimeve të emergjencave. - Detyrat dhe përgjegjësitë e tyre.	Drejtorja e shkollës, komisioni	Nentor	Baza ligjore për secilin shërbim
4.	Pergatitja e profilit të shkollës: - Planimetria e shkollës; - Harta e zonës në të cilën është vendosur shkolla; - Kontaktet për rastet e emergjencave.	Komisioni dhe përfaqësuesit e shërbimeve të emergjencave.	Dhjetor	Projekti dhe skicat e marra nga Bashkia
5.	Seancë trajnuese me nxënësit që përfaqësojnë këshillin e çdo klase, prindër dhe mësues. - Veprimet që duhen realizuar në rast rënie zjarri.	Komisioni dhe përfaqësuesit e shërbimeve të emergjencave.	Janar	Udhëzuesi për shkollat 9-vjeçare
6.	Veprimtari praktike. - Stërvitje për rënie zjarri.	Komisioni i emergjencave	Shkurt	Udhëzuesi për shkollat 9-vjeçare

7.	Projekt me nxënësit e klasave të VIII-ta. - Si të mbrohemi nga tërmetet.	Mësuesit, nxënësit	Mars	Udhezues, interneti
8.	Diskutim me nxënësit e klasave të IX-ta. - Përmbytjet dhe llojet e tyre; - Si të mbrohemi nga përmbytjet	Mësuesit, nxënësit	Prill	Udhezues, interneti
9.	Ekspozitë me punime të nxënësve me temë: <i>Siguria në shkollë</i>	Drejtoria e shkollës, komisioni	Maj	

PLAN I VEPRIMTARIVE
“EDUKIMI PËR MENAXHIMIN E EMERGJENCAVE DHE SIGURINË NË SHKOLLË”
SHKOLLA 9-VJEÇARE KULLË, DURRËS

Nr.	Objektivat	Veprimtaritë/ Nënveprimtaritë	Periudha e zbatimit	Personat përgjegjës dhe anëtarët e grupit të punës	Partnerët/ Bashkëpunime
	<p>1.Parandalimin dhe menaxhimin e rreziqeve natyrore ne shkolle ose nga faktore te tjere</p>	<p>1.Trajnim me stafin pedagogjik te shkolles mbi edukimin e rreziqeve natyrore menaxhimin e situatave emergjente dhe sigurine ne shkolle.(perfaqesues te</p>	<p>1.Muaji shtator (java e katert)</p>	<p>1.Stafi drejtues i shkolles Komisioni i sigurisë në shkolle Psikologia e shkolles</p>	<p>1.Prindër (Përfaqësues të Këshillave të prindërve) Nxënës (Përfaqësues të</p>

	<p>2.Ndërgjegjësimi i komunitetit të shkollës për përgatitjen për rrezikun ndaj fatkeqësive natyrore dhe menaxhimin e situatave emergjente</p> <p>3.Përgatitja dhe aftësimi i komunitetit të shkollës për njohjen, parandalimin dhe</p>	<p>keshillit te prinderve dhe te qeverise se nxensve)</p> <p>2.Realizimi i broshurave,fletpalosjeve dhe posterave mbi sigurine ne shkollë nga qeveria e nxenesve nen mbikqyrjen e komisionit te sigurise ne shkollë</p> <p>3.Realizimi i oreve edukative mbi sigurine ne rastet e rreziqeve natyrore</p>	<p>1.Muaji tetor (java e pare dhe ne vazhdimsi pergjate vitit shkollor)</p> <p>3.13 tetor</p>	<p>2.Qeveria e nxenesve</p> <p>Komisioni i sigurise ne shkollë</p> <p>3.Mesuesit kujdestare ne bashkepunim me mesuesit e</p>	<p>Qeverisë së Nxënësve)</p> <p>Stafi pedagogjik</p> <p>2.Nxenesit</p> <p>Psikologia</p> <p>Mesuesit</p> <p>3.Nxenesit</p> <p>Stafi drejtues i shkolles</p>
--	---	--	---	--	---

	<p>menaxhimin e situatave emergjente</p> <p>4.Ndergjegjsimi i komunitetit te shkolles per pergatitjen per rrezikun ndaj fatkeqsive natyrore dhe menaxhimin e situatave emergjente</p>	<p>4.Fushate sensibilizuese nga perfaqshues eksperte te mjedisit te zones emergjencave per rendesinë e pergatitjes per reduktimin e rrezikut të fatkeqsive natyrore.</p> <p>5. Pyetësorë me nxënës, mësues, prindër për vlerësimin e nevojave dhe burimeve të shkollës.</p>	<p>4.Dhjetor (java e pare)</p>	<p>lendes se gjeografise</p> <p>4.Eksperte te mjedisit te zones</p> <p>Stafi drejtues i shkolles</p> <p>Komisioni i sigurise ne shkolle</p> <p>Qeveria e nxenesve</p>	<p>Mesuesit</p> <p>4.Mesuesit</p> <p>Nxenesit</p> <p>Psikologia</p> <p>Prinderit</p> <p>Perfaqshues te komunitetit</p>
--	---	---	--------------------------------	---	--

	<p>5.parandalimin dhe menaxhimin e situatave emergjente dhe faktoreve te tjere ne shkolle</p> <p>6.Pergatitja dhe aftesimi i komunitetit te shkolles per njohjen,parandalimin dhe menaxhimin e situatave emergjente</p>	<p>6.Fokus grupe – Diskutim: Rëndësia e njohjes dhe zbatimit të rregullave të sigurisë në shkollë.</p>	<p>5.Shkurt (java e dyte)</p> <p>6.Mars (java e pare)</p>	<p>5.Qeveria e nxenesve psikologia</p> <p>6.Mesuesit Nxenesit</p>	<p>5.Mesues Prinder Stafi drejtues</p> <p>6.Stafi pedagogjik Prinder</p>
--	---	--	---	---	--

					I ftuar nje perfaqses i kryqit te kuq
--	--	--	--	--	---

PLAN I VEPRIMTARIVE

**“EDUKIMI PËR MENAXHIMIN E EMERGJENCAVE DHE SIGURINË NË SHKOLLË”
SHKOLLA 9-VJEÇARE “5 MAJI”, URA VAJGURORE BERAT**

Nr	Objektivat	Veprimtaritë/ Nënveprimtaritë	Periudha e zbatimit	Personat përgjegjës dhe anëtarët e grupit të punës	Partnerët/ Bashkëpunim e
I.	Planifikimi i veprimtarive në nivel klase/shkollë për njohjen, parandalimin dhe	4. Identifikimi i fushave prioritare të veprimtarive: <ul style="list-style-type: none"> - Tryeza të rrumbullakta me mësues për identifikimin e hapësirave kros dhe ekstra për përfshirjen e veprimtarive. - Pyetësorë me nxënës, mësues, prindër për vlerësimin e nevojave dhe burimeve të shkollës. 	Muaji Shtator (Java e tretë)	Stafi drejtues i shkollës Komisioni i sigurisë në shkollë	Prindër (Përfaqësues të Këshillave të prindërve) Nxënës (Përfaqësues të Qeverisë së Nxënësve)

	menaxhimin e rreziqeve natyrore ose nga faktorë të tjerë	<p>5. Përgatitja e planit të veprimtarive kros dhe ekstrakurrikulare, në nivel klase/shkolle.</p> <p>6. Ngritja dhe pasurimi i këndit të sigurisë në shkollë (Afishimi i numrave të emergjencave, shpallja e veprimtarive të planifikuara, foto të veprimtarive, rregullorja e sigurisë etj).</p>	<p>Muaji Shtator (Java e tretë)</p> <p>Muaji Shtator (Java e katërt)</p> <p>Muaji Shtator (Java e katërt dhe në vazhdimë si përgjatë vitit shkollor)</p>		<p>Drejtoria Arsimore Rajonale</p> <p>Pushteti lokal</p> <p>Shpetim Vrapi</p>
II.	Ndërgjegjësi mi i komunitetit të shkollës	3. Veprimtari ndërgjegjësuese në nivel shkolle me rastin e 13 Tetorit- Ditës ndërkombëtare të reduktimit të rrezikut ndaj fatkeqësive natyrore:	13 Tetor	<p>Stafi drejtues i shkollës</p> <p>Komisioni i sigurisë</p>	<p>Komuniteti i shkollës</p> <p>Prindër</p>

	për përgatitjen për rrezikun ndaj fatkeqësive natyrore dhe menaxhimin e situatave emergjente	<ul style="list-style-type: none"> - Përgatitje e posterave/fletëpalosjeve. - Prezantime nga ekspertë të mjedisit ose të autoritetit të emergjencave për rëndësinë e përgatitjes për reduktimin e rrezikut të fatkeqësive natyrore. 		<p>Qeveria e nxënësve</p> <p>Mësuesi koordinator</p>	<p>Specialistë të mjedisit ose të autoritetit të emergjencave</p> <p>Myfit Senko</p>
III	Përgatitja dhe aftësimi i komunitetit të shkollës për njohjen, parandalimin dhe menaxhimin	<p>4. Orë mësimore model – Veprimtari kroskurrikulare në lëndën e gjeografisë për tërmetet, masat që merren për mbrojtjen ndaj tyre dhe procedurat e veprimit në rast tërmeti.</p> <p>4. Veprimtari – Simulimi i dhënies së ndihmës së shpejtë në rast të një situatave emergjente.</p>	<p>Dhjetor (Java e parë)</p> <p>Shkurt (Java e dytë)</p>	<p>Mësues i gjeografisë(Asllan Hajdini) dhe nxënësit e klasave të 7-ta</p> <p>Nxënës të klasave të 9-ta</p> <p>Mësues të Edukimit fizik(Ervis</p>	<p>I ftuar një sizmiolog ose një përfaqësues i autoritetit të emergjencave</p> <p>Myfit Senko</p>

	e situatave emergjente	5. Orë edukative – Diskutim: Rëndësia e njohjes dhe zbatimit të rregullave të sigurisë në shkollë.	Mars (Java e parë)	Koxhaj) dhe Biologjisë(Mimoz a Sala) Mësuesit kujdestarë(Olger ta Dokaj) Nxënësit e shkollës	Anëtarë të tjerë të stafit mësimor (mësues, psikolog, punonjës social) I ftuar një përfaqësues i Kryqit të Kuq
	Pergatitja e nxenesve te shkolles ne rastet e	Veprimtari-Senati i shkolles dramatizon nje raste emergjence para shkolles	Mars (Java e dyte)	Mesuesi Ervis Koxhaj dhe senati I shkolles Mesuesi I gjeografise	Senati dhe MZSH

<p>emergjencave civile.</p> <p>Nxenesit njohin arsyen pse ndodhin termetet dhe evakuimin nga zona e termetit.</p>	<p>Ore edukative:Termetet.Masat qe duhet te marrim ne raste se ndodhin.</p> <p>Bisede:Nxenes,prinder,mesues,MZSH</p> <p>Ore mesimore:Permytjet natyrore.</p> <p>Veprimtari:Punonjesit e MZSH trajnojne nxenesit se si duhet te veproje per tu evakuar.</p> <p>Mbledhje:Mesues,nxenes,prinder,punonjes te MZSH</p>	<p>Prill (Java e pare)</p> <p>Prill (Java e dyte)</p> <p>Maj (Java e pare)</p> <p>Maj (Java e dyte)</p>	<p>Asllan Hajdini,mesuesja e biologjise Mimoza Sala</p> <p>Nxenesit,mesuesi I gjeografise Asllan Hajdini,mesuesja biologjise Mimoza Sala,punonjesit e MZSH dhe infermierja e shkoles.</p> <p>Mesuesi i gjeografise Asllan Hajdini,mesuesi i edukimit fizik Ervis Koxhaj,mesuesja</p>	<p>MZSH</p> <p>MZSH dhe qendra shendetesore.</p> <p>MZSH dhe qendra</p>
<p>Nxenesit aftesohen dhe praktikohen per rastet e evakuimit nga</p>				<p>MZSH dhe qendra</p>

	<p>zonat e permbytura.</p> <p>Njihemi me rezultatet e punes mbi emergjencat civile.</p>		<p>Qershor (Java e pare)</p>	<p>e biologjise Mimoza Sala,punonjesit e MZSH,infermierja e shkolles</p> <p>Mesuesit Asllan Hajdini,Ervis Koxhaj,Mimoza Sala,Punonjesit e MZSH.</p>	<p>shendetesorte .</p> <p>MZSH dhe qendra shendetesore.</p>
--	---	--	------------------------------	---	---

PLAN I VEPRIMTARIVE
“EDUKIMI PËR MENAXHIMIN E EMERGJENCAVE DHE SIGURINË NË SHKOLLË”
SHKOLLA 9-VJEÇARE “ARDIAN KLOSI”, TIRANË

Nr.	Objektivat	Veprimtaritë/ Nënveprimtaritë	Periudha e zbatimit	Personat përgjegjës dhe anëtarët e grupit të punës	Partnerët/ Bashkëpunime
I.	Planifikimi i veprimtarive në nivel klase/shkollë për njohjen, parandalimin	7. Identifikimi i fushave prioritare të veprimtarive: - Tryeza të rrumbullakta me mësues për identifikimin e hapësirave kros dhe	Muaji Shtator (Java e tretë)	Stafi drejtues i shkollës Komisioni i sigurisë në shkollë	Prindër (Përfaqësues të Këshillave të prindërve) Nxënës (Përfaqësues të

<p>dhe menaxhimin e rreziqeve natyrore ose nga faktorë të tjerë</p>	<p>ekstra për përfshirjen e veprimtarive.</p> <p>- Pyetësorë me nxënës, mësues, prindër për vlerësimin e nevojave dhe burimeve të shkollës.</p> <p>8. Përgatitja e planit të veprimtarive kros dhe ekstrakurrikulare, në nivel klase/shkolle.</p> <p>9. Ngritja dhe pasurimi i këndit të sigurisë në shkollë (Afishimi i numrave të emergjencave, shpallja e veprimtarive të planifikuara, foto të veprimtarive, rregullorja e sigurisë etj).</p>	<p>Muaji Shtator (Java e tretë)</p> <p>Muaji Shtator (Java e katërt)</p> <p>Muaji Shtator (Java e katërt dhe në vazhdimësi</p>		<p>Qeverisë së Nxënësve)</p> <p>Pushteti lokal</p>
--	---	--	--	--

			përgjatë vitit shkollor)		
II.	Ndërgjegjësimi i komunitetit të shkollës për përgatitjen për rrezikun ndaj fatkeqësive natyrore dhe menaxhimin e situatave emergjente	5. Veprimtari ndërgjegjësuere në nivel shkolle me rastin e 13 Tetorit- Ditës ndërkombëtare të reduktimit të rrezikut ndaj fatkeqësive natyrore: <ul style="list-style-type: none"> - Përgatitje e posterave/fletëpalosjeve. - Prezantime nga ekspertë të mjedisit ose të autoritetit të emergjencave për rëndësinë e përgatitjes 	13 Tetor	Stafi drejtues i shkollës Komisioni i sigurisë Qeveria e nxënësve Mësues	Komuniteti i shkollës Prindër Specialistë të mjedisit ose të autoritetit të emergjencave

		për reduktimin e rrezikut të fatkeqësive natyrore.			
III.	Përgatitja dhe aftësimi i komunitetit të shkollës për njohjen, parandalimin dhe menaxhimin e situatave emergjente	<p>1.Orë mësimore model – Veprimtari kroskurrikulare në lëndën e gjeografisë për tërmetet, masat që merren për mbrojtjen ndaj tyre dhe procedurat e veprimit në rast tërmeti.</p> <p>2.Veprimtari – Simulimi i dhënies së ndihmës së shpejtë në rast të një situatave emergjente.</p> <p>3.Orë edukative – Diskutim: Rëndësia e njohjes dhe</p>	<p>Dhjetor (Java e parë)</p> <p>Shkurt (Java e dytë)</p> <p>Mars (Java e parë)</p>	<p>Mësues të gjeografisë dhe nxënësit e klasave të 7-ta</p> <p>Nxënës të klasave të 9-ta</p> <p>Mësues të Edukimit fizik dhe Biologjisë</p> <p>Mësuesit kujdestarë</p>	<p>I ftuar një sizmiolog ose një përfaqësues i autoritetit të emergjencave</p> <p>Anëtarë të tjerë të stafit mësimor (mësues,</p>

		zbatimit të rregullave të sigurisë në shkollë.		Nxënësit e shkollës	psikolog, punonjës social) I ftuar një përfaqësues i Kryqit të Kuq
		<p>4.Veprimtari</p> <p>Perdorimi i shkalleve te emergjences.</p> <p>Rastet kur duhen perdorur dhe si duhen perdorur ato.</p> <p>5.Veprimtari</p> <p>Ndihma e pare.</p> <p>4 Hapat per dhenien e ndihmes se pare</p> <p>*Gjakderdhja</p>	Prill (Java e parë)	Mësuesit kujdestarë Nxënësit e shkollës	Stafi drejtues i shkollës

	<p>*Plage ne lekure</p> <p>*Demtime ne kocka ,muskuj,kyce.</p> <p>Demostrime nga nxenesit.</p> <p>6.Ore edukative</p> <p>Rendesia e njohjes me rregullat e qerkullimit rrugor.</p> <p>(Hartimi i posterave ,fletepalosjeve,etj)</p>	<p>Prill (Java e trete)</p> <p>Maj (Java e dyte)</p>	<p>Mësuesja e biologjise, doktori i shkolles,mesues i edukimit fizik</p> <p>Mësuesit kujdestarë</p> <p>Nxënësit e shkollës</p>	<p>I ftuar nje perfaqesues i policise se shtetit.</p>
--	--	--	--	---

PLAN I VEPRIMTARIVE
“EDUKIMI PËR MENAXHIMIN E EMERGJENCAVE DHE SIGURINË NË SHKOLLË”
SHKOLLA 9-VJEÇARE “ASDRENI”, KORÇË

TE DHENA PER SHKOLLEN

SHKOLLA 9-VJECARE ASDRENI NDODHET NE LAGJEN 17, RRUGA”BAJRAM CURRI” KORCE NE BRENDESI TE QYTETIT PRANE RRETHOHET NGA SHTEPI PRIVATE DHE KA NJE OBORR TE VOGEL PRAPA SAJ POR PA DALJE NE RRUGE

SHKOLLA ESHTË NJE GODINE DY KATESHE ME 12 KLASA MESIMORE NJE LAB. INFORMATIKE DHE NJE PALESTER TE IMPTOVIZUAR .SHKOLLA KA KORRIDORE TE GJERA TE AJROSUR NGA DRITARET SHKALLE TE GJERA POR NUK KA SHKALLE EMERGJENCE APO DHE DALJE EMERGJENCE.

NE SHKOLLE NDODHEN TE INSTALUARA 4 ZJARRFIKSE (dy per cdo kat)DHE ALARMET E ZJARRIT NGA DY PER CDO KAT .

VUNERABILITETI

RREZIKU

1- TERMET

SHKOLLA ESHTË E RREZIKUAR :

NIVELI NGA 1-5

3

2- PERMBYTJE	2
3- ZJARR	3
4- RRESHQITJE E TOKES	1
5- MUNGESHE UJI	1
6- NDOTJA KIMIKE	0

Nr	Vunerabiliteti identifikimi i mungesave	veprimtaria	Personi pergjegjes	Buxheti	koha
1	Ekipi i ndihmes se pare te patrajnuar	Organizimi i trajnimeve	Markelian Pambuku		Muaji mars
2	Informimi ne rast termeti Fushate informimi	Organizimi i trajnimeve me punonjesit e zjarrfiksit Korce(specialist)	M. Pambuku G. Tasellari V. Rushi		Muaji Prill maj
3	Realizimi i nje simulimi(loje) ne rast fatkeqesie "TERMETI"	Organizimi i lojes	M.Pambuku V.Rushi A.Mitre G.Tasellari		Muaji maj

			V. Cicko		
--	--	--	----------	--	--

PLAN I VEPRIMTARIVE
“EDUKIMI PËR MENAXHIMIN E EMERGJENCAVE DHE SIGURINË NË SHKOLLË”
SHKOLLA 9-VJEÇARE “AVNI RUSTEMI”, TIRANË

Nr	Objektivat	Veprimtaritë/ Nënveprimtaritë	Periudha e zbatimit	Personat përgjegjës dhe anëtarët e grupit të punës	Partnerët/ Bashkëpunime
1	<p>Studimi i terrenit për evidentimin e rreziqeve në shkollë</p> <p>Krijimi i hartës së evakuimit të shkollës dhe ekspozimi në mjediset e shkollës</p> <p>1.Hyrjet dhe daljet</p>	<p>Gjatë muajit</p> <p>Janar 2019</p>	Komisioni	Shkollë	Komisioni

	<p>2.Rrugët e evakuimit nga secili mjedis në ndërtesë</p> <p>3.Vendndodhjen e kutisë së ndihmës së parë</p> <p>4.Vendosjen e fikësve të zjarrit</p> <p>5.Vendet e siguresave</p> <p>6.Sallën e hapësirave e grumbullimit dhe qendrimit në raste emergjencave</p>				
2	<p>Fushatë informim dhe ndërgjegjësim i nxënësve për sigurinë në shkollë</p>	<p>Muaji Shkurt 2019</p>	<p>Komisioni</p> <p>Nxënësit e shkollës</p> <p>kl 6-7-8-9</p>	<p>Në klasa</p>	<p>Komisioni</p> <p>Nxënësit e shkollës</p> <p>kl 6-7-8-9</p>

3	<p>1.Të përgatitemi për t'u mbrojtur nga fatkeqësitë.</p> <p>2.Realizimi i një rasti emergjence</p>	Muaji Mars 2019	<p>Grupe nx.</p> <p>kl VII- VIII</p>	Në shkollë	<p>Komisioni</p> <p>Nxënësit e shkollës</p> <p>kl 7-8</p> <p>Inxhinieri</p> <p>Xh.Gjylameti</p>
4	<p>Hartimi i hartës së zonës përreth shkollës</p> <p>1.Daljet nga ndërtesa e shkollës</p> <p>2.Qendra shëndetësore</p> <p>3.Stacioni zjarrfikës</p> <p>4.Vendndodhja e strehimeve</p>	Prill	Komisioni	Në shkollë	<p>Komisioni</p> <p>Nxënësit e shkollës</p> <p>kl 6-7-8-9</p>

5	Simulime me skenarë të ndryshëm	Muaji maj 2019	Nx. kl VIII B+C	Në shkollë	Komisioni

PLAN I VEPRIMTARIVE
“EDUKIMI PËR MENAXHIMIN E EMERGJENCAVE DHE SIGURINË NË SHKOLLË”
SHKOLLA 9-VJEÇARE “BESËLIDHJA”, LEZHË

Menaxhimi për rrezikun e emergjencave në shkollë synon:

- *Reduktimin e rrezikut të fatkeqesive dhe emergjencave në shkollë dhe zonën pranë saj .*
- *Menaxhimin e shpejtë dhe eficient të situatës në shkollë.*
- *Sigurimin pa ndërprerje dhe në mënyrë të vazhdueshme të procesit mësimor dhe edukues.*

Objektivat e menaxhimit të emergjencave janë:

- *Hartimi dhe zhvillimi i një sistemi të menaxhimit të rrezikut të emergjencave në shkollë;*
- *Identifikimi i fatkeqesive natyrore të mundshme dhe i rasteve të fatkeqesive të shkaktuara nga njeriu në shkollë dhe zonën përreth saj ;*
- *Vlerësimi i vulnerabilitetit dhe kapaciteteve të shkolles;*
- *Zhvillimi i veprimtarive përgatitore për reduktimin e rrezikut të fatkeqesive dhe emergjencave;*
- *Zhvillimi i një culture të sigurisë dhe qëndrueshmërisë ndërmjet nxënësve ,mësuesve,drejtuesve dhe aktoreve të tjerë në shkollë ,përmes zhvillimit të njohurive inovacionit dhe edukimit;*
- *Zhvillimi i veprimtarive për zbutjen e pasojave të emergjencave ,të cilat përfshijnë sigurimin e jetës dhe reduktimin e dëmtimeve ,mbrojtjen e pronës dhe materialeve të tjerë të shkolles.*

Konceptet dhe terminologjia:

- **Fatkqesia** → është një ngjarje, pasojat e së cilës janë shkaktuar nga forcat natyrore të pakontrolluara ose nga arsye të tjera, të cilat kërcenojnë ose demtojnë jetën dhe shëndetin e popullatës .
- **Fatkeqesit natyrore** → përfshijnë tërmetet ,përmblytjet ,thatesiraaat atmosferike të tejzgjatura,rreshqitjet arkitektonike,orteket,ererrat e forta ,zjarret në pyje dhe në mjediset e banuara etj.
- **Rreziku** → është një gjendje serioze, reale dhe e menjehershme ,që kërcënon jetën e njerezve ,te gjese e gjalle,demtimitin e pronës publike etj që mund të shkaktohet nga fatkeqesit natyrore ose nga fatkeqesit e tjera.
- **Emirgjence civile** → është një situatë e shkaktuar nga faktorë natyrore ,ekologjike,industrial,sociale,veprime,terroriste ,veprime ushtarake etj të cilat sjellin dëm të menjehershme e të rëndë për jetën për shëndetin e popullatës etj .
- **Parandalim**→ është një kuadër masash që merren para ndodhjes së një ngjarjeje për shmangien ose zvogelimin e dëmeve që mund të vijnë nga ngjarja.
- **Masa mbrojtëse** → janë masa organizative ,teknike dhe çdo masë tjetër për mbrojtjen e menjehershme individuale dhe kolektive të njerezve ,gjese se gjalle,pasurisë etj kundër pasojave të fatkeqesive natyrore ose fatkeqesive të tjera.

- **Planizim e perballim I emirgjencave civile** → është përgatitja e autoriteteve publike ,e institucioneve dhe organeve të qeverisjes qendrore e vendore ,e personave juridike ,publike ose private,etj duke përcaktuar marrjen e masave për parandalimin dhe për riaftësimin e gjendjes së shkaktuar nga veprimi I rrethanave emergjente .
- **Vulnerabiliteti** → përfshin karakteristikat dhe rrethanat e një komuniteti , të një sistemi ose asetit që e bëjnë atë të ndjeshëm për pasojat e një rreziku.
- **Kapaciteti** → është kombinim I të gjitha pikave të forta ,cilesive dhe burimeve në dispozicion brenda një komuniteti ,shoqërie ose organizate që mund të përdoret për të arritur qëllimet.

Nr	Tematika	Afati	I ngarkuari
1	Njohja e çdo klase me rreziqet e pranishme në shkollë dhe shkaqet kryesore të rrezikut .	Janare	Mesuesi kujdestare Klasa 6-9.
2	Njohja e nxenesve me planin e sigurisë dhe masat mbrojtëse të sigurisë.	Shkurt	Mesuesi kujdestare Klasa 6-9.

3	Si te mbrohemi ne rast termeti. Klasa 5-6 dhe 7-9	Prille	Mesuesit kujdestare.
4	Si te veprojmë ne rast zjarri ne shkolle ? Po ne shtëpi?	Maj	Mesuesit kujdestare Nxenesi kujdestare I klases.

PLAN I VEPRIMTARIVE
“EDUKIMI PËR MENAXHIMIN E EMERGJENCAVE DHE SIGURINË NË SHKOLLË”
SHKOLLA 9-VJEÇARE “EFTALI KOÇI”, DURRËS

Në shkollë Eftali Koçi ,në bazë të Dispozitës Normative ,nenet 115,116,117 të saj është ngritur komisioni I sigurisë,shëndetit,mirëmbajtjes dhe mjedisit. Në bashkëpunim me qeverinë e nxënësve ,këshillin e prindërve,këshillin e mësuesve ,drejtorinë e shkollës ka parashikuar veprimtaritë me në fokus : “Edukimin për menaxhimin e emergjencave dhe sigurinë në shkollë.”

Këto veprimtari janë integruar në:

- a) Në planin e veprimtarive në kuadër të SH.Q.K
- b) Në planet edukative në nivel klase.
- c) Në disa orë mësimi në lëndët që kanë tema të cilat lidhen me edukimin për menaxhimin e emergjencave.

Veprimtaritë për menaxhimin e emergjencave synojnë:

- 1.Reduktimin e rrezikut të emergjencave e fatkeqësive në shkollë.
- 2.Menaxhimin e shpejtë e eficient të situatave emergjente në shkollë.
- 3.Rritjen e shkallës së sigurisë në mënyrë të vazhdueshme në shkollë.

Kalendari I veprimtarive Mars-Qershor 2019

Nr.	OBJEKTIVAT	VEPRIMTARITË	PERIUDHA E ZBATIMIT	PERSONAT PËRGJEGJËS	PARTNERËT PËR BASHKËPUNIM
1	Krijimi I një kulture bashkëpunimi dhe solidariteti midis nxënësve, mësuesve dhe komunitetit.	Tryezë sensibilizuese: Së bashkë mund të menaxhojmë më mirë situatat emergjente	21.03.2019	Komisioni I sigurisë së shkollës	Këshilli I mësuesve
2	Reduktimi I rrezikut të fatkeqësive dhe emergjencave	Përdorimi I pajisjeve kundër zjarrit	25.04.2019	Komisioni I sigurisë së shkollës	Specialistë të Qendrës së Zjarrfikësit Durrës
3	Menaxhimi I shpejtë dhe eficient I situatës emergjente në shkollë	Evakuimi I nxënësve dhe I stafit pedagogjik në rast fatkeqësish	23.05.2019	Drejtoria e shkollës	Mësues të edukimit fizik
4	Sigurimi në mënyrë të vazhdueshme I sigurisë në shkollë	Të njohim nivelin e sigurisë në shkollë	07.06.2019	Komisioni I sigurisë së shkollës	Qeveria e nxënësve

PLAN I VEPRIMTARIVE

**“EDUKIMI PËR MENAXHIMIN E EMERGJENCAVE DHE SIGURINË NË SHKOLLË”
SHKOLLA 9-VJEÇARE “GJON BUZUKU”, TIRANË**

NR	Vulnerabiliteti I indentifikuar	Veprimtaria		Periudha	Pergjegjes	Buxhet	
1	Takim I komisionit te menaxhimit te shkolles	Krijimi I planit te veprimit.Harta e evakuimit te shkolles. Ndertimi I ekipeve pergjegjese	1	Janar	Drejtoresha		
2	Fushate informimi	Telefoni I Urgjences	2	Shkurt	Grupi I komunikimit dhe sistemit te alarmit		

3	Evakuimi I nje kati	Evakuimi I nje kati ne nje rast emergjence	1	Mars	Drejtori a grupet e komisionit te evakuimit		
4	Perdorimi I nje fikese zjarri	Demonstrim per fiksen e zjarrit. Kutine e Ndhimes se pare	1	Prill	Grupi I zjarrit Punonjes Zjarrfikes		
5	Krijimi I ekipit Ndhimes se Pare ne vazhdim	Organizim trajnimi	2	Maj	M. Sulaj P. Vreshtazi		
6	Takim Komisioni	Puna e bere. Dobesite Permiresimet		Qershor	Drejtori Gr Emergjence		

PLAN I VEPRIMTARIVE
“EDUKIMI PËR MENAXHIMIN E EMERGJENCAVE DHE SIGURINË NË SHKOLLË”
SHKOLLA 9-VJEÇARE “ISMAIL QEMALI”, KORÇË

Profili i shkollës.

Shkolla "Ismail Qemali" ndodhet në lagjen 17 ; Rruga "Ajet Gjindolli".

Adresë emaili: shkismailqemali@yahoo.com

- ❖ Shkolla është themeluar si godinë në vitin 1957, por është hapur si mjedis mësimor në vitin 1964.
- ❖ Eshtë rikonstruktuar për herë të fundit në vitin 2003 dhe pritet të rikonstruktohet sërish për shkak të amortizimeve dhe problemeve infrastrukturore që janë shfaqur vit pas viti.
- ❖ Në shkollë zhvillojnë mësim 225 nxënës në 15 klasa, nga të cilat:
 - ❖ 9 klasa cikël i ulët, (Arsim Fillor) me mesatarisht 14 nxënës/ për klasë ; dhe
 - ❖ 6 klasa cikël i lartë , (Arsim I mesëm I ulët) me mesatarisht 17 nxënës për klasë.

Tek ne japin mësim 24 mësues , 2 drejtuese dhe së bashku me punonjësit e shërbimit janë gjithsej 30 individë.

- ❖ Shkolla nuk ka palestër,por një klasë të madhe të sajuar si të tillë . Ajo mezi i plotëson nevojat mësimore vetëm për vajzat, ndërsa për djem kemi përshtatur një klasë normale për lojëra . Jemi ende në proces për ndërtimin e një këndi sportiv të ri, mundësuar nga Eorl Vision
- ❖ Shkolla ka nga 2 banjo djemsh dhe 2 vajzash, në çdo kat ,por krejt tualetet janë në gjendje delicate edhe pse vit pas viti janë bërë ndërhyrje të konsiderueshme.

Shkolla është e ndërtuar me 4 kate.

Në katin e katërt ka 1 dalje emergjence dhe një dalje kryesore. Aty aktualisht nuk po zhvillohet mësim, pasi kemi reduktim të madh të numrit të nxënësve. Tualetet shërbejnë për stafin mësimdhënës.

Në katin e tretë kemi një dalje emergjence nga një krah I shkollës. Ka 6 klasa,sallën e mësuesve, drejtorinë , kabinetin e informatikës, kabinetin e fizikës .

Kati i dytë ka 6 klasa , nëndrejtorinë , kabinetin e biologjisë dhe “ palestrën”.

Kati I parë ka 6 klasa, njëra prej tyre është në process përshtatjeje për të mbështetur punën me fëmijët me nevoja të veçanta , e mundësuar sërish nga Eorl Vision, kabinetin e kimisë, bodrumin për drutë dhe materialet e dala nga përdorimi gjatë vitit,si dhe dhoma e punonjësve të shërbimit

Ngritja e komisionit të emergjencave civile

Në shkollë është ngritur komisioni i emergjencave civile.

Nr	Emër Mbiemër	Pozicioni I punës	Pozicioni	Nr . tel
-----------	---------------------	--------------------------	------------------	-----------------

1-	Lonora Hysolli	Drejtori	Kryetar	
2-	Petro Karafili	Prind	Anëtar	
3-	Altin Çollaku	Mësues	Anëtar	
4-	Irena Mehmet	Mësues	Anëtar	
5-	Mirela Kapedani	Punonjëse sociale	Anëtar	
6-	Marin Grabocka	Nxënës	Anëtar	
7-	Ermelinda Troka	Nxënëse	Anëtar	

Rolet dhe përgjegjësitë e Komisionit të menaxhimit të emergjencave:

Komisioni i menaxhimit të emergjencave:

- Siguron mbrojtjen e nxënësve dhe stafit të shkollës;
- Harton, zbaton, monitoron dhe vlerëson planin e menaxhimit të emergjencave;

- Zhvillon kapacitetet për zbutjen e pasojave të fatkeqësive dhe emergjencave;
- Zhvillon vlerësime të vazhdueshme të rrezikut dhe vulnerabilitetit të ndërtesës dhe të zonës përreth shkollës;
- Planifikon dhe zbaton veprimtari për zbutjen e pasojave të fatkeqësive dhe emergjencave;
- Organizon veprimtari që nxisin krijimin e kulturës së bashkëpunimit dhe solidaritetit në shkollë në raste emergjencash, si p.sh., simulime evakuimi, kuice, aktivitete sportive etj.;
- Ndërton sistemin e reagimit ndaj emergjencave të shkollës dhe siguron përfshirjen e komunitetit në këtë proces;
- Siguron dhe mirëmban pajisjet e ndryshme, si pajisjet e ndihmës së parë, fikësen e zjarrit etj.;
- Siguron koherencën dhe koordinimin e Planit të menaxhimit të emergjencave me planet e zhvillimit të pushtetit lokal;
- Siguron dhe koordinon pjesëmarrjen, bashkëpunimin dhe shkëmbimin e përvojave ndërmjet nxënësve dhe aktorëve të tjerë në këtë proces;
- Krijon një sistem alarmi në shkollë;
- Zhvillon takime të paktën tri herë në vit;
- Rishikon dhe përditëson planin të paktën një herë në vit;
- Mban shënime për vendimet që ndërmerr.

Veprimet në rast emergjence

- Komisioni shërben si një grup koordinator në rastin e një emergjence;
- Komisioni ndërmerr vendime në lidhje me procedurat që do të ndiqen në rast të një emergjence të tilla, si alarmi fillestar, evakuimi, lëvizja për në vendstrehim etj;

Komisioni për menaxhimin e emergjencave, në varësi të nevojave të shkollës, mund të krijojë ekipe të veçanta të cilët përmbushin detyra dhe funksione specifike në rastet e emergjencave.

Identifikimi i fatëkeqësive natyrore dhe shkallës së rrezikut

Fatëkeqësitë me të cilat mund të përballlet shkolla jonë janë:

Fatëkeqësitë që mund të prekin shkollës	Propabiliteti	Vunerabiliteti	Shkallla e rrezikut	Niveli irrezikut
Tërmetet	4	4	16	Mesatar
Përmbytjet	3	3	9	Mesatar
Zjarret.	3	3	9	Mesatar

Stuhitë e dëborës	3	3	9	Mesatar
-------------------	---	---	---	---------

Niveli i rrezikut të goditjes nga fatëkeqësitë natyrore në shkollën tonë është **mesatar**.

Ambientet e brendshme të shkollës nuk përbëjnë rrezik në rast emergjencash. Lende të ndryshme kimike janë të sistemuara nëpër mjedise jo të ekspozuara. Dokumente të ndryshme që mund të jenë në rrezik nga zjarret janë të mbyllura në mjedise të sigurta dhe të mbrojtura.

Plani i masave për parandalimin e rrezikut:

- Kutia e ndihmës së shpejtë.
- Fikëset e zjarrit.
- Prania e shenjave dalluese në rast evakuimi.
- Paralajmërimi nga grupi I punës dhe drejtimi I individëve drejt daljeve të emergjencës.
- Simulime për veprime në raste emergjence.
- Trajnime dhe informacione te grupeve të punës dhe stafit pedagogjik në raste emergjence.

Në rast zjarri

Parandalimi i zjarrit dhe masat për sigurinë ndaj zjarrit kërkojnë testime të herëpashershme dhe mirëmbajtje të vazhdueshme në shkollë.

Vlerësojmë që:

- Burimet e zjarrit dhe materiale që digjen lehtë të jenë të izoluara dhe të siguruara.

Këto përfshijnë instalimet elektrike, pajisjet elektrike si soba, ngrohëset elektrike, ose lëngje të djegshme.

- Korridoret e daljes të jenë të përcaktuara qartë për të lehtësuar evakuimin e sigurt në rast zjarri.
- Sistemet e alarmit të jenë funksionale.
- Fikësit e zjarrit të jenë të mbushur.

Në rast tërmeti

Për sigurinë nga tërmeti mendojmë rreth objekteve që mund të rrëshqasin, bien dhe sidomos për ato objekte të cilat mund të dëmtojnë. Përcaktojmë çfarë duhet bërë, kush mund ta bëjë dhe kur.

Përcaktojmë prioritetet:

- Sigurojmë sendet që mund të dëmtojnë, si p.sh., pajisje të rënda, pajisje për ngrohje/ ftohje, rafte librash etj. Kujdes të gjitha dyert e daljeve duhet të hapen nga jashtë.
- Sigurojmë objektet/sendet që kanë vlerë ekonomike ose kulturore, si p.sh., kompjutera, pajisje audio-vizive etj.

Hapat që ndiqen në rast fatkeqësish.

Në rast tërmeti

Gjatë momentit të lëkundjes:

- Që në momentin e parë të lëkundjes, mësuesi apo kushdo tjetër i rritur udhëzon me zë të lartë “Shpejt në pozicion për tërmet: përkulu, mbulohu dhe prit!”.
- Kur tërmeti ndalon, evakuojmë menjëherë ndërtesën.

Në klasa:

- Personi që është më afër derës duhet ta hapë atë plotësisht.
- Përkuluni në gjunjë dhe mblidhuni sa më shumë të jetë e mundur.
- Mbuloni kokën, qafën dhe fytyrën.
- Futuni poshtë një tavoline nëse keni afër një të tillë.
- Mbahuni fort te tavolina ose mbulesa në të cilën jeni futur.
- Qëndroni larg mobiljeve të rënda.
- Kini kujdes në përdorimin e shkallëve. Shpeshherë shkallët janë pak rezistente dhe mund të dëmtohen.

Në laborator:

- Largoni të gjitha materialet e rrezikshme ose që mund të marrin zjarr para se të futeni poshtë tavolinës.

Jashtë në sipërfaqe të hapur:

- Nëse gjatë tërmetit gjendeni jashtë, qëndroni larg mureve që mund të shemben, pemëve dhe shtyllave elektrike.
- Përkuluni, mbulohuni dhe prisni, duke mbrojtur me krahët tuaj kokën dhe qafën.
- Në rast se ndodheni në autobus ose në furgonin e shkollës, shoferi duhet të ndalojë mjetin larg zonës së rrezikut.

Në rast përmytjeje

Para përmytjes:

- Jepni njoftime të vazhdueshme për evakuimin para përmytjes, për mbrojtjen e pajisjeve dhe të dokumentacionit.
- Zhvendosuni në një zonë të sigurt.
- Praktikoni planet e emergjencës dhe evakuimit për të qenë gjithmonë të gatshëm.
- Përgatitni një paketë me ushqime, ujë dhe disa veshje rezervë.
- Mbani gjithmonë kutinë e ndihmës së shpejtë në vende të sigurta bashkë me dokumentet e rëndësishme, për t'i marrë me vete në një moment rreziku.

Gjatë përmbytjes:

- Evakuoni menjëherë të gjitha hapësirat që përfshihen nga përmbytja.
- Vendosuni në një zonë të sigurt në pjesën e sipërme të ndërtesës.
- Mos provoni të kaloni përmes rrymës së ujit.
- Qëndroni larg vendeve të rrezikshme, si puseta, kanale ujëmbledhës, pasi vrulli i ujit mund t'ju marrë duke rrezikuar jetën.

Pas përmbytjes:

- Kthehuni në godinë pasi të kenë urdhëruar drejtuesit e emergjencës.
- Mos takoni asnjë çelës elektrik pa u bindur për sigurinë e rrjetit.
- Kontrolloni rrëzimin e mureve, shkallëve, dyerve apo kanalet e ndryshme të shkarkimeve të ujërave dhe lajmëroni autoritetet për dëmtimet e ndryshme të banesës.
- Asnjëherë mos përdorni për pirje ujin që vjen nga rrjeti i ujësjellësit sepse mund të jetë i infektuar. Kur është e domosdoshme duhet ta ziejmë atë.
- Mos përdorni ushqimet e lagura nga përmbytja sepse mund të sëmureni.

Në rast zjarri

Nëse shihni zjarr:

- Nëse zjarri është i vogël, shuajini flakët me fikësen e zjarrit ose mbulojini me një mbulesë.

- Aktivizoni alarmin e zjarrit.
- Telefononi zjarrfikësen.
- Evakuoni ndërtesën.

Nëse dëgjoni alarmin për zjarr:

- Trajtojeni si emergjencë të vërtetë.
- Ndiqni procedurat e evakuimit të ndërtesës.
- Kurrë mos e hapni një derë të mbyllur pa kontrolluar më parë nëse është e nxehtë.
- Mos e hapni derën e nxehtë.

Nëse jeni në një mjedis me shumë tym:

- Përkuluni në gjunjë dhe ecni për jashtë.
- Merrni frymë vetëm me hundë.
- Mbajeni frymën sa më shumë të jetë e mundur.
- Vendosni një rrobë mbi gojë dhe hundë.

Në rast stuhie dhe rrufesh

Nëse jeni brenda një mjedisi:

- Qëndroni larg telefonit. Linjat e telefonit mund të përcjellin elektricitet.

- Hiqni nga priza kompjuterat dhe pajisje të tjera.
- Mbyllni dritaret dhe qëndroni larg tyre.

Nëse jeni jashtë:

- Qëndroni larg ujit pasi uji përcjell elektricitetin.
- Shkoni drejt një strukture të qëndrueshme, të mbyllur.
- Asnjëherë mos qëndroni poshtë një peme.
- Mos qëndroni shtrirë mbi tokë.
- Mblidhuni sa më shumë të jetë e mundur.

Nëse rrufeja godet dikë:

- Kërkoni ndihmë.
- Njoftoni shërbimin e urgjencës mjekësore.
- Jepini ndihmën e parë. Nëse personi nuk merr frymë, bëni frymëmarrjen artificiale.
- Kontrollojeni për dëmtime dhe djegie të mundshme.
- Zhvendoseni në një vend më të sigurt.
- Keni parasysh, personat e goditur nga rrufeja nuk mbajnë ngarkesa elektrike dhe mund të mbahen në krah.

Nr.	Objektivat	Veprimtaritë/ nënveprimtaritë	Periudha e zbatimit	Personat përgjegjës dhe anëtarët e grupit tëpunës	Partnerët-Bashkëpunimet
1	Vlerësimi I vulnerabilitetit dhe kapaciteteve të shkollës	<p>Pyetësorë me nxënës, mësues, prindër për vlerësimin e nevojave dhe burimeve të shkollës.</p> <p>Tryeza të rrumbullakta me mësues për identifikimin e hapësirave kros dhe ekstra për përfshirjen e veprimtarive.</p>	Gjatë muajit Shtator	<ul style="list-style-type: none"> -Komisioni I sigurisë -Specialistë -Ëord Vision -Mësuesit kujdestarë 	<p>Komuniteti</p> <ul style="list-style-type: none"> -Qendra shëndetësore e zonës -Policia,zjarrfikësja -Kryqi I Kuq
2	Planifikimi i veprimtarive në nivel klase/shkolle për	Identifikimi i fushave prioritare të veprimtarive		Drejtoria e shkollës,	<ul style="list-style-type: none"> -Kryqi I Kuq Specialistë(zjarrfikës)

	njohjen, parandalimin dhe menaxhimin e rreziqeve natyrore ose nga faktorë të tjerë	<p>Përgatitja e planit të veprimtarive në nivel klase/shkolle.</p> <p>Rifreskimi i këndit të sigurisë në shkollë (Afishimi i numrave të emergjencave, shpallja e veprimtarive të planifikuara, foto të veprimtarive, rregullorja e sigurisë etj).</p>	Gjatë dy javëve të para të muajit tetor	<p>Komisioni I sigurisë</p> <p>Qeveria e nx.</p> <p>-Mësues, nxënës dhe komuniteti</p>	policia
3	Ndërgjegjësimi i komunitetit të shkollës për përgatitjen për rrezikun ndaj fatkeqësive natyrore dhe menaxhimin e situatave emergjente	<p>-Trajnime me specialistë /mësuesit, nxënësit së bashku me komunitetin</p> <p>Veprimtari ndërgjegjësuere në nivel shkolle me rastin e 13 Tetorit- Ditës ndërkombëtare të reduktimit të rrezikut ndaj fatkeqësive natyrore:</p>		<p>Stafi drejtues i shkollës</p> <p>Komisioni i sigurisë</p> <p>Qeveria e nxënësve</p> <p>Mësues</p>	<p>Komuniteti i shkollës</p> <p>Prindër</p> <p>Specialistë të mjedisit ose të autoritetit të emergjencave</p>

		<p>Përgatitje e posterave/fletëpalosjeve.(Krijim posteri me numrat e emergjencës.)</p> <p>Prezantime nga ekspertë të mjedisit ose të autoritetit të emergjencave për rëndësinë e përgatitjes për reduktimin e rrezikut të fatkeqësive natyrore.</p>	<p>13 tetor</p> <p>Gjatë muajit Nëntor</p>		
--	--	--	--	--	--

4	<p>Përgatitja dhe aftësimi i komunitetit të shkollës për njohjen, parandalimin dhe menaxhimin e situatave emergjente, përmes veprimtarive konkrete</p>	<p>Diskutim: Rëndësia e njohjes dhe zbatimit të rregullave të sigurisë në shkollë.</p> <p>Krijimi i hartave orientuese të evakuimit</p> <p>-Ilustrim me videoprojektor i rasteve të emergjencave natyrore dhe civile.</p> <p>Shpërndarja e fletëpalosjeve për situata të ndryshme emergjence</p> <p>-Mundësojmë krijimin e Kutisë së ndihmës së shpejtë të klasave dhe shkollës dhe pajisjen e tyre me bazën e duhur materiale</p> <p>Edukimi për një të ushqyer të shëndetshëm</p>	<p>Dhjetor (java e parë)</p> <p>Dhjetor (java e dytë)</p> <p>Dhjetor (java e tretë)</p> <p>Janar (java e dytë)</p>	<p>Drejtorja e shkollës,</p> <p>Komisioni I sigurisë</p> <p>Qeveria e nx.</p> <p>-Mësues, nxënës dhe komuniteti</p>	
---	---	---	--	---	--

		<p>Edukimi për menaxhimin e emergjencave</p> <p>Edukimi rrugor: Siguria në rrugë, siguria për jetën(129)</p> <p>Siguria në internet</p>	<p>Janar (java e tretë)</p> <p>Janar (java e katërt)</p> <p>Shkurt (java e parë)</p> <p>Shkurt (java e dytë)</p>	<p>Komisioni I sigurisë</p> <p>Mësuesit kujdestarë</p> <p>Komisioni I sigurisë</p> <p>Mësues I biologjisë</p> <p>Mësues I qytetarisë</p>	<p>Kryqi I Kuq. Ëorld Vision.</p> <p>Punëtoret e shërbimit psiko-social të shkollës.</p> <p>Mjeku</p> <p>Mësues I biologjisë, mjeku I lagjes</p> <p>Kryqi I Kuq.</p> <p>Punëtoret e shërbimit psiko-social të shkollës.</p> <p>Mjeku</p> <p>Mësues kujdestar, Shërbimi policor</p>
--	--	---	--	--	--

			Shkurt (java e tretë)	Komisioni I sigurisë	
--	--	--	--------------------------	-------------------------	--

	<p>Zhvillimi I aftësive praktike në situata emergjence duke demonstruar qetësi,shkathtësi dhe forma efikase zgjidhjeje sipas specifikës së rastit.</p>	<p>Dramatizim I pjesëve letrare:</p> <p>”Lushi shpëtimtari”</p> <p>“Një natë në flakë”</p> <p>“Njëmision i vështirë” nga autori F.Topi.</p> <p>-Diskutimi dhe shkrimi i rregullave të dala nga këto pjesë.</p> <p>Hartimi I rregullores së emergjencave nëpër klasa</p> <p>Simulimi I një situatë emergjence në rast zjarri (Klasa e 9)</p> <p>-Simulimi I një situatë emergjence në rast tërmeti (Klasa e 8)</p>	<p>Gjatë muajit Mars</p> <p>Mars (java e fundit)</p> <p>Prill(java e parë)</p> <p>Prill(java e dytë)</p>	<p>Komisioni I sigurisë</p> <p>Mësuesit kujdestarë</p> <p>Komisioni I emergjencave</p> <p>Specialistë përkatës,</p>	<p>Mësues I gjuhës shqipe dhe arteve, mjeku I lagjes</p> <p>Kryqi I Kuq.</p> <p>Punëtorët e shërbimit psiko-social të shkollës.</p> <p>Mjeku</p> <p>Mësues kujdestar,</p> <p>Kryqi I Kuq.</p> <p>Ëorl Vision.</p> <p>Specialistë përkatës, nga shërbimi zjarrfikës</p>
--	---	---	--	---	--

	<p>Simulimi I një situatë emergjence në rast përmbajtje (Klasa e 7)</p> <p>Konkursi dhe ekzpozita e vizatimeve të nx.më tematikat e sugjeruara nga Kryqi I Kuq</p>	<p>Prill(java e tretë)</p> <p>Prill(java e katërt)</p> <p>Maj (java e parë)</p>	<p>nga shërbimi zjarrfikës</p> <p>Specialistë përkatës.</p> <p>Nxënës/Mësues</p> <p>Prindër/Psikolog</p> <p>Mësuesit kujdestarë dhe mësuesi I arteve</p>	<p>Punëtorët e shërbimit psiko-social të shkollës.</p> <p>Mjeku.</p>
	<p>-Dhënia e ndihmës së parë në kthimin e vetëdijes dhe shmangien e rreziqeve të aksidentimit.</p> <p>Dhënia e ndihmës së parë në rifillimin e punës</p>	<p>Maj (java e dytë)</p>	<p>Specialistë përkatës.</p> <p>Nxënës/Mësues</p> <p>Prindër/Psikolog</p>	<p>Kryqi I Kuq.</p> <p>Punëtorët e shërbimit psiko-social të shkollës.</p> <p>Mjeku.</p>

		<p>së zemrës dhe të frymëmarrjes.</p> <p>Simulimi I një situatë emergjence në rast stuhie dhe rrufesh (Klasa e 6)</p> <p>Simulimi I një situatë emergjence në rast të rrëshqitjes së dherave në tokë (Klasa e 5)</p>	<p>Maj (java e tretë)</p> <p>Maj (java e katërt)</p> <p>Qershor (java e parë)</p>	<p>Specialistë përkatës.</p> <p>Nxënës/Mësues</p> <p>Prindër/Psikolog</p> <p>Specialistë përkatës.</p> <p>Nxënës/Mësues</p> <p>Prindër/Psikolog</p> <p>Specialistë përkatës.</p> <p>Nxënës/Mësues</p> <p>Prindër/Psikolog</p>	<p>Specialistë përkatës.</p> <p>Nxënës/Mësues</p> <p>Prindër/Psikolog</p> <p>Specialistë përkatës.</p> <p>Nxënës/Mësues</p> <p>Prindër/Psikolog</p> <p>Specialistë përkatës.</p> <p>Nxënës/Mësues</p> <p>Prindër/Psikolog</p>
--	--	--	---	---	---

PLAN I VEPRIMTARIVE
“EDUKIMI PËR MENAXHIMIN E EMERGJENCAVE DHE SIGURINË NË SHKOLLË”
SHKOLLA 9-VJEÇARE “KOSOVA”, LEZHË

Nr	Temat dhe veprimtarite	Personat pergjegjes	Afati
1	<i>Takim informues per planin e sigurise ne shkolle .</i>	Komisioni Nxenesit	15.01.2019
2	<i>Bisede:Siguria ne klase dhe ne shkolle ne rast zjarri .</i>	Mesuesja kujdestare Kl -9(A,B,C)	17.01.2019
3	<i>Veprimtari :Siguria ne raste zjarri .</i>	Mesuesja kujdestare Kl -9(A,B,C)	19.01.2019
4	<i>Project:Siguria ne rruge (Bisede)</i>	Mesuesja V.Docaj Nx.klasa 2.	05.02.2019

5	<i>Bisede : Dhenia e ndihmes se pare .</i>	Kl -9 Mjek Mesues A.M , A.GJ ,R.L	15.02.2019
6	<i>Siguria ne rruge(poster ,fletepalosje)</i>	Msuesja V.Docaj Nxenesit e klases 2 -B	19.02.2019
7	<i>Project :Siguria ne rruge (veprimtari)</i>	Mesuesja kl.2-B Polic Nxenesit	05.03.2019
8	<i>Bisede</i> <i>Veprimtari:Menaxhimi I situatave ne rast termeti.</i>	Komisioni Kl. 7.A,B M.K Fahrije Balla Albana Pervathi	09.04.2019

9	<i>(Veprimtari) Bisede: Si te mbrohemi nga shkarkimet e rrymes elektrike .</i>	M .Kujdestare Kl.VI-VIII Nxenesit	14.05.2019
10	<i>Veprimtari :Ndihma e shpejte</i>	M.Kujdestare Kl.9 Mjeku:Francest Gjergji	20.02.2019

PLAN I VEPRIMTARIVE

“EDUKIMI PËR MENAXHIMIN E EMERGJENCAVE DHE SIGURINË NË SHKOLLË” SHKOLLA 9-VJEÇARE “MËSONJËTORJA E PARË SHQIPE”, KORÇË

Nr	Objektivat	Veprimtari	Periudha	Personi pergjegjes	Partneret
1	Vleresimi I kapaciteteve te shkolles	-Pyetesor me mesuesit -Pyetesor me nxenesit -Takim me ekipet lendore per planifikimin e veprimtarive ne rang shkolle e klase	Shtator (java II) Tetor (java I)	Kryetari I komisionit e anetaret e tij Pergjegjesit e ekipeve lendore	Mesues –nxenes

2	<p>Informimi dhe trajnimi I stafit te shkolles.</p> <p>Pajisja e shkolles me sinjalistiken e nevojshme</p>	<p>-Trajnim I stafit te shkolles ne rast emergjence</p> <p>-Veprimtari ndergjegjesuese ne nivel shkolle me rastin e 13 Tetorit,dites nderkombetare te reduktimit te rezikut ndaj fatkeqesive natyrore</p> <p>-Harta e emergjencave</p> <p>-Shenjat treguese</p>	<p>tetor</p> <p>13 tetor</p> <p>Nentor</p>	<p>Drejtoria</p> <p>Komisioni I sigurise</p> <p>Qeveria e nxenesve</p> <p>Mesues</p>	<p>Prinder</p> <p>Specialiste te mjedisit dhe autoritet te emergjencave</p>
---	--	---	--	--	---

3	Te aftesohen praktikisht nxenesit dhe mesuesit ne rast emergjence (termet dhe zjarr)duke ndjekur udhezimet e duhura	Veprimtari praktike: 1-simulim ne rast termeti -dhenia e ndihmes se pare -grumbullimi I nxenesve ne vend te sigurt 2- simulim ne rast zjarri 3- Bisede me nje zjarrfikes	Ne klase Shkurt Ne shkolle Mars Prill	Komisioni I sigurise Mesuesi kujdestar	Nxenesit Mesuesit Roja Zjarrfikes
---	---	---	---	---	--

PLAN I VEPRIMTARIVE
“EDUKIMI PËR MENAXHIMIN E EMERGJENCAVE DHE SIGURINË NË SHKOLLË”
SHKOLLA 9-VJEÇARE “NËNË TEREZA”, LEZHË

Synimi:

- *Të nxisim aftësinë e nxënësve e komitetit për të njohu , parandaluar, menaxhuar rreziqet e ndryshme që mund të krijohen në shkollë nga dukuri natyrore dhe të tjera.*

Objektivat :

- *Identifikimi(Vlerësimi I gjendjes së shkollës) mbi fatkeqësive natyrore , e rasteve te të tjera të shkaktuara në shkollë dhe zonën perreth saj)*
- *Zhvillimi I veprimtarive përgatitore per sigurinë e jeës ndermjet nxwnwsve, mwsuesve, drejtuesve dhe aktoreve të tjerë, përmes zhvillimit të njohurive të marra.*
- *Praktika të përditësuara për zbutjen e pasojave (evakuim , sinjalizim, etj) të emergjencave , të cilat përfshijnë sigurimin e jetës e mbrojtjen e pronës së përbashkët.*

Plan veprimi për raste emergjence (specifike)

Nr	Objektivat	Veprimtaritë	Afati	Personat përgjegës	Partneret dhe bashkëpunëtorët
1	1.Njohja dhe parandalimi i rreziqeve që mund të përballemi në shkollë.	1.Takimi mësues - prindër nxënës për përcaktimin dhe krijimin e a. një plani sigurie, b. masat që mund të merren për parandalimin e rreziqeve të mundshme.	Tetor	Ekipi I emergjencës.	Komisioni Prindër
2	2.Përgatitja e nxënësve ,stafit të mesuesve dhe komunitetit . Për evakuim në rast emergjence .	2.Përcaktimi i zonave të rrezikut në rast zjarri dhe permbytjeje (afishimi i shenjave të rrezikut, hapja e kanalizimeve të oborrit të shkollës). 3.Sigurimi i mjeteve te nevojshme per raste zjarri dhe përmytjeje(fikese zjarri etj).	Tetor Tetor	Stafi I shkollës. Nxënës. Prindër.	Zjarrëfikës Komuniteti Drejtoria Arsimore Rajonale Pushteti lokal

3	3. Menaxhimi sa me i mirë i situatave të emergjencës.	4. Veprimtari te improvizuara ne planin e edukimit te seciles klase. Evakuimi I nxenesve ne rast zjarri dhe permbytjeve.	Tetor-Prill Maj		Komisioni
---	---	--	------------------------	--	-----------

PLAN PUNE

Komisioni i shëndetësisë, sigurisë, mirëmbajtjes dhe mjedisit, 2018-2019

Nr	Veprimtaria	Afati	I ngarkuari
1.	- Ngritja e komisionit.	Tetor 2018	Drejtoria
2.	-Veprimtari në rang shkolle (Pastrimi I territorit , Brenda dhe jashtë shkollës) “Për një Shqipëri të pastër”	Nëntor 2018	Komisioni Mës. Kujdestar.
3.	-Takim me punojësintë policisë. (Java e policisë) 1.“Siguria në rrugë...” 2. “Mospërdorimi I bimeve narkotike ...” -Takim me përfaqesuesit e shëndetësisë(Cassa Ola)” / bashkëpunim me Kryqin e Kuq Shqiptar, dega Lezhë	Dhjetor - Mars 2019 Shkurt 2019	Komisioni Policia

4.	<p><i>Veprimtari praktike” Dhënia e ndihmës së shpejtë”</i></p> <p>Bashkëpunim me degën e emergjencave civile(zjarrfikëseve)</p> <p><i>Bisedë: Si duhet të mirëbroheni nga zjarri dhe termeti.</i></p>	Mars 2019	<p>Përfaqësues nga Qendra shënëdetsore/ dhe KKSH, Dega , lezhë</p> <p>Komisioni</p> <p>Punonjësirt e zjarfiksave</p> <p>Komisioni</p>
5.	<p>Mbledhje e komisionit:</p> <p>-Analize e punës vjetore.</p>	Maj 2019	<p>Komisioni</p> <p>Kryetari</p>

PLAN I VEPRIMTARIVE
“EDUKIMI PËR MENAXHIMIN E EMERGJENCAVE DHE SIGURINË NË SHKOLLË”
SHKOLLA 9-VJEÇARE “PANDELI CALE”, KORÇË

Nr	Objektivat	Veprimtarite	Periudha e zbatimit	Personat pergjegjes	Partnere/Bashkepunimet
1	Vleresimi i nevojave dhe kapaciteteve te shkolles	Identifikimi i nevojave me checklist per emergjencat a. Ngritja e grupit te punes b. Pergatitja e checlistes se emergjencave c. Analizimi I emergjencave	Shtator-Tetor	*Drejtoria e shkolles *Komisioni I sigurise te shkolles	*Mesues *Nxenes *Prinder

2	Planifikimi i veprimtarive vjetore te shkolles per menaxhimin e emergjencave	<p>Hartimi ie planit vjetor</p> <p>a.Trajtimi I stafit te mesuesve</p> <p>b. Krijimi I hartave te evakuimit ne raste zjarri</p>	Nentor-Dhjetor	<p>*Drejtoria e shkolles</p> <p>*Komisioni I sigurise te shkolles</p> <p>*Qeveria e nxenesve</p> <p>*Mesuesit</p> <p>Keshilli I prinderve</p>	<p>*Perfaqesues te pushtetit local</p> <p>*Punonjes te zjarrfikses</p>
3	Aftesimi i nxenesve per te perballuar rastet ne rrezik zjarri	<p>*Lojra stimuluese</p> <p>*Pergatitje fletepalosjesh</p> <p>*Ore mesimore</p>	Janar-Prill	<p>*Drejtoria e shkolles</p> <p>*Komisioni i sigurise te shkolles</p> <p>*Mesues</p> <p>*Qeveria e nxenesve</p>	<p>*Mesues</p> <p>*Nxenes</p> <p>* Punonjes te zjarrfikses</p>

4	Analizimi I punes	Raport per vlefshmerine e planit	Maj	*Drejtoria e shkolles *Komisioni I sigurise te shkolles *Mesues *Qeveria e nxenesve	

PLAN I VEPRIMTARIVE
“EDUKIMI PËR MENAXHIMIN E EMERGJENCAVE DHE SIGURINË NË SHKOLLË”
SHKOLLA 9-VJEÇARE “PAL ENGJËLLI”, TIRANË

Nr .	Vulnerabiliteti I identifikuar/mungesa e kapaciteteve	Veprimtaria	Prioriteti 1-3	Burimet e nevojshme	Periudha e zbatimit	Personat pergjegjes	Buxheti
1	Percaktimi i shenjave Dalluese qe tregojne rruget e daljeve emergjente	Ndertimi dhe vendosja e shenjave ne mure	1	Leter adezive e kuqe	Shkurt	M.Spahiu B.Hystunaj	1000

						Bashkepunetor e nxenes dhe prinder	
2	Ekipi i ndihmes se pare i patrajnuar	Organizimi i trajnimit	2	Perfaqesues te kryqit te kuq	Mars	A.Shyti (Stafi pedagogjik)	
3	Stervitja e nxenesve per emergjenca te ndryshme	Zhvillimi i stervitjeve pergjate vitit me nxenesit	1	Mesues,nxenes,ore t edukative	Pergjate vitit	Mesuesit kujdestare	

PLAN I VEPRIMTARIVE
“EDUKIMI PËR MENAXHIMIN E EMERGJENCAVE DHE SIGURINË NË SHKOLLË”
SHKOLLA 9-VJEÇARE “ZIHNI TOSKA”, BERAT

Synimet:

- ✓ Ndërgjegjësimi i komunitetit të shkollës;
- ✓ Zhvillimi i kapaciteteve për parandalimin, mbrojtjen, menaxhimin e situatave emergjente dhe zbutjen e pasojave, si dhe
- ✓ Krijimi i një kulture bashkëpunimi dhe solidariteti të nxënësve, mësuesve dhe pjesës tjetër të stafit mësues, prindërve dhe anëtarëve të tjerë të komunitetit.

Periudha e parë Shtator –Dhjetor

N r	Objektivat	Veprimtarite	Afati	Personat pergjegjes	Burimet	Bashkepunimet
1	Nndergjegjesi m i nx,mesues dhe	Ngritja e komisionit te emergjencave	shtator	drejtoria		Shkolla komuniteti

2	komuniteti rreth veprimeve ne rast rreziku	Vleresimi i vulnerabilitetit(rrezikut)	tetor	Komisioni i sigurise Ne shkolle	manuali	Mesues/nxenes prinder
3		Hartimi i planit vjetor	tetor	komisioni	manuali	Komisioni/mesues Nxenes/prinder
4		Ndergjegjesimi i nxenesve ,prinderve dhe mesuesve rreth veprimeve ne rast fatkeqesie	Tetor /nento r	komisioni/psikolog infirmier	Videoprojektor Fletepalosje Piktura/foto	Komisioni/mesues Nxenes/prinder
5	Përgatitja dhe aftësimi i komunitetit të shkollës për njohjen, parandalimin dhe menaxhimin e	Demonstrim ne rast zjarri. Trajnim i mesuesve(MKZ)	Dhjetor mars	QN Mesuesi koordinatori i QN Psikolog Punojnes te zjarrfikeses	Pajisjet per MKZ	Punonjesit e zjarrfikeses

	situatave emergjente					
--	----------------------	--	--	--	--	--

Periudha e dyte Janar -Mars

N r	Objektivat	Veprimtarite	Afati	Personat pergjegjes	Burimet	Bashkepunimet
1	Nndergjegjesi m i nxenesit,mes uesit e prindit per shmngien e rrezikut ne internet.	Informim i komunitetit te shkolles	janar	Komisioni i sigurise	shkolla	Shkola komuniteti
		Ngritja e grupeve te patronazhit per nxenesit me aftesi ndryshe. Veprimtari me QN	janar	QN/psikolog	Burime njerezore	Shkolla /komuniteti
2		Hartim i pyetesoreve(per emergjencen ,energjine,shigjet	shku rt	Komisioni i sigurise.QN	manuali	Mesues/nxenes prinder

		ata fosforeshente,per perdorimin e fikses se zjarrit)				
3		Perpunimi i pyetesoreve.Nevojat me primare qe ka shkolla per emergjence.	shkurrt	Komisioni i sigurise.QN	pyetesoret	Komisioni/mesues Nxenes/prinder
4		Veprimtari praktike”10 shkuti dita e internetit te sigurte,mbrojtja e femijeve nga ajo qe quhet dhune virtuale”	shkurrt	Komisioni i sigurise.QNR. Mali	Postera/fletepalosje/videoprojektor	Komisioni/mesues Nxenes/prinder
5	Nndergjegjesimi i nxenesit,mesuesit e prindit per shmngien	Ndergjegjesim.Hartimi i posterave dhe fletepalosjeve-si te shmangim	mars			Komisioni/mesues Nxenes/prinder

	e rrezikut ne situata e mjedise te ndryshme	rrezikun ne ambiente te ndryshme				
6	Edukojme te nxenesit kujdesin per shmngien e rrezikut ne situata e mjedise te ndryshme	Veprimtari praktike Harta e rreziqeve Pergatitja e cantes se emergjences	mars	R.Mali/Klubi i librit	Libri i Canaosinaj”Aventurat ne ishullin lundrues” Tregimi “Piknik ne mal”	Punonjesit e zjarrfikeses

Periudha e trete Prill-Qershor

Nr	Objektivat	Veprimtarite	Afati	Personat pergjegjes	Burimet	Bashkepunimet
1	Edukojme te nxenesit kujdesin per shmngien e	Demonstrim”si te veprojmë ne rast zjarri ne shkolle”	prill	Komisioni i sigurise	shkolla	Shkola komuniteti

	rrezikut ne rast zjarri.	Perfshirja e gjithe shkolles				
2	Edukojme te nxenesit kujdesin per shmngien e rrezikut ne ore te ndryshme mesimore.	Veprimtari praktike Si te shmangim rrezikun e proceseve kimike ne oren e kimise”	prill	Illirjan Shehu/Kl IX	Kabineti i kimise	Shkolla/komuniteti
3	Edukojme te nxenesit kujdesin per shmngien e rrezikut ne ore te ndryshme mesimore.	Veprimtari praktike Cdo mesues ne oren kujdestari Hartojme rregulla “Si te shmangim rrezikun ne oren e edkimit fizik”	maj	Mesues/nxenes	shkolla	Shkolla/komuniteti
4	Reflektojme mbi punen e kryer.	Analize e punes se kryer	qershor	Komisioni i sigurise.	shkolla	Komisioni/mesues Nxenes/prinder

PLAN I VEPRIMTARIVE
“EDUKIMI PËR MENAXHIMIN E EMERGJENCAVE DHE SIGURINË NË SHKOLLË”
SHKOLLA 9-VJEÇARE “ANDROKLI KOSTALLARI”, TIRANË

Plani i emergjencave dhe sigurisë në shkollë është dokument i cili realizon bashkëpunimin e personelit të mësimdhënies, komunitetin dhe nxënësit për parandalimin dhe përballimin e emergjencave që mund të krijohen.

Ai është i zbatueshëm për fazat kryesore të ciklit të emergjencave sidomos për parapërgatitjen, përgjigjen dhe rikthimin në gjendjen normale.

Bazuar informacioneve, rreziqet e mundshme që mund të prekin shkollën tonë janë fatkeqësitë natyrore, të tilla si tërmetet, stuhitë, reshjet e dëborës dhe fatkeqësitë të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore, të tilla si zjarret.

SYNIMI I PLANIT:

- Reduktimi i rrezikut të fatkeqsive dhe emergjencave në shkollë dhe jashtë saj.
- Menaxhimin e shpejtë dhe eficient të situatës emergjente në shkollë.
- Sigurimin pa ndërprerje dhe në mënyrë të vazhdueshme të procesit mësimor dhe edukues.

Objektivat e planit janë:

- Hartimi dhe zhvillimi i një sistemi të menaxhimit të emergjencave në shkollë.
- Identifikimi i fatkeqsive natyrore të mundshme dhe i rasteve të fatkeqsive të shkaktuara nga njeriu në shkollë dhe zonën përreth saj.
- Vlerësimi i vulnerabilitetit dhe kapaciteteve të shkollës.
- Zhvillimi i veprimtarive përgatitore për reduktimin e rrezikut të fatkeqsive dhe emergjencave.
- Zhvillimi i një kulturë të sigurisë dhe qëndrueshmërisë ndërmjet nxënësve, mësuesve, drejtuesve dhe aktorëve të tjerë në shkollë, përmes zhvillimit të njohurive, inovacionit dhe edukimit.
- Zhvillimi i veprimtarive për zbutjen e pasojave të emergjencave, të cilat përfshijnë sigurimin e jetës dhe reduktimin e dëmtimeve, mbrojtjen e pronës dhe materialeve të tjerë të shkollës.

ORGANIZIMI I MENAXHIMIT TË EMERGJENCAVE.

Drejtori i shkollës kryen këto detyra:

- Monitoron dhe menaxhon situatën emergjente duke koordinuar me mësuesit e pranishëm.
- Thërret stafin pedagogjik.
- Kërkon ndihmë kur situata e emergjencës kalon përtej mundësive apo kapaciteteve që ka shkolla.
- Mban kontakte të vazhdueshme dhe bashkërendon veprimet me strukturat lokale (njësia bashkiake dhe policia)

Komisioni i përballimit të emergjencave në shkollë.

Detyrat e tij janë:

- Bashkërendon veprimet me gjithë stafin e mësuesve gjatë gjithë etapave të emergjencës.
- Bashkërendon veprimet me komunitetin, strukturat lokale, si dhe me vullnetarët apo donatorët e ndryshëm.
- Vlerëson nevojat dhe dëmtimet e shkaktuara, kostot e rehabilitimit.

Drejtuesi i menaxhimit të situatës.

Në situatën e emergjencës së krijuar, drejtuesi i menaxhimit të situatës bëhet përgjegjës dhe kryen këto detyra:

- Vepron sipas udhëzimeve që merr komisioni i përballimit të emergjencave në shkollë dhe raporton sa herë kërkohet nga komisioni.
- Bashkërendon strukturat që vijnë në ndihmë.
- Mban lidhje të rregullta dhe kontakte me të gjithë të interesuarit.

Nr.	Objektivat	Veprimtaritë/ Nënveprimtaritë	Periudha e zbatimit	Personat përgjegjës dhe anëtarët e grupit të punës	Partnerët/ Bashkëpunime
------------	-------------------	--	--------------------------------	---	------------------------------------

1	Planifikimi në nivel shkolle për njohjen, parandalimin dhe menaxhimin e rreziqeve natyrore	- Tryezë të rrumbullakët me mësues dhe prindër për ndërgjegjësimin ndaj rreziqeve natyrore.	Para fillimit të vitit shkollor (shtator 2018)	Komisioni i sigurisë në shkollë.	Prindër, DAR, pushteti lokal
		1. Përgatitja e planit me veprimtari extra dhe kros kurrikulare në nivel klase dhe shkolle. (kurrikula me zgjedhje dhe planet e kujdestarise)	Para fillimit të vitit shkollor (shtator 2018)	Drejtoria e shkollës Ekipi lëndor	
		2. Ngritja dhe pasurimi i këndit të sigurisë në shkollë (Afishimi i numrave të emergjencave)	Shtator 2018	Lozjana Zela psikologe e shkollës dhe Kryetar e ekipit për ndihmën e parë dhe	

				mbështetjen psiko-sociale	
2	Ndërgjegjësimi I komunitetit të shkollës për rrezikun ndaj fatkeqsive natyrore dhe menaxhimin e situatave emergjente	1.Prezantimi nga ekspertë të mjedisit ose të autoritetit të emergjencave për rëndësinë e përgatitjes për reduktimin e rrezikut të fatkeqësive natyrore.	13 tetor 2018 dita për reduktimin e rrezikut ndaj fatkeqsive	Komisioni i sigurisë në shkollë.	Ekspertë të mjedisit
3	Përgatitja dhe aftësimi I komunitetit të shkollës për njohjen, parandalimin dhe menaxhimin e situatave emergjente	1.Prezantimi nga ekspertë të ndërmarrjes nr 3 për radhën e veprimeve se si do të mbrohemi në rast të rënies së zjarrit në shkollë. (simulime në ambjentet e shkollës se si të përdorim fikset e zjarrit)	Dhjetor 2018	Arbër Sherifi kryetar i ekipit për mbrojtjen nga zjarri	Ekspertë të ndërmarrjes nr 3.

		2. Prezantimi i dhënies së ndihmës së parë për stafin e mësuesve.	Mars 2019	Arbër Sherifi kryetar i ekipit për mbrojtjen nga zjarri dhe mësues I edukimit fizik	Mjek ortoped
--	--	---	------------------	---	--------------

PLAN I VEPRIMTARIVE
“EDUKIMI PËR MENAXHIMIN E EMERGJENCAVE DHE SIGURINË NË SHKOLLË”
SHKOLLA 9-VJEÇARE “22 TETORI”, BERAT

Plani i menaxhimit të rrezikut të emergjencave **synon**:

- Reduktimin e rrezikut të fatkeqësive dhe emergjencave në shkollë dhe zonën pranë saj;
- Sigurimin pa ndërprerje dhe në mënyrë të vazhdueshme të procesit mësimor dhe edukues.
- Menaxhimin e shpejtë dhe eficient të situatës emergjente në shkollë;

Objektivat e planit të menaxhimit të reduktimit të rrezikut të fatkeqësive dhe emergjencave janë:

- Hartimi dhe zhvillimi i një sistemi të menaxhimit të rrezikut të emergjencave në shkollë;
- Zhvillimi i veprimtarive përgatitore për reduktimin e rrezikut të fatkeqësive dhe emergjencave;
- Zhvillimi i veprimtarive për zbutjen e pasojave të emergjencave, të cilat përf-shijnë sigurimin e jetës dhe reduktimin e dëmtimeve, mbrojtjen e pronës dhe materialeve të tjerë të shkollës.
- Vlerësimi i vulnerabilitetit dhe kapaciteteve të shkollës;

- Zhvillimi i një kulture të sigurisë dhe qëndrueshmërisë ndërmjet nxënësve, mësuesve, drejtuesve dhe aktorëve të tjerë në shkollë, përmes zhvillimit të njohurive, inovacionit dhe edukimit;

Në procesin e zhvillimit të planit do të marrin pjesë, përfaqësues të ndryshëm të komunitetit të shkollës si p.sh., zjarrfikësit, qendra shëndetësore, përfaqësues të pushtetit lokal, përfaqësues të autoritetit të emergjencave, përfaqësues të organizatave partnere në shkollë etj.

KRIJIMI I KOMISIONIT TË MENAXHIMIT TË EMERGJENCAVE

Komisioni i menaxhimit të emergjencave është një autoritet i cili kujdeset dhe merr përgjegjësi për të gjitha aspektet e menaxhimit të rrezikut të fatkeqësive dhe emergjencave. Reduktimi i rrezikut të emergjencave është përgjegjësi e të gjithë aktorëve në shkollë, dhe jo vetëm e drejtuesve të saj Anëtarët e këtij komisioni duhet të punojnë së bashku për planifikimin dhe zbatimin e veprimtarive të planit të menaxhimit të rrezikut të emergjencave.

Komisioni i menaxhimit të rreziqeve të emergjencave realizon tre takime ; një takim para fillimit të shkollës ose në nisje të saj, një në mes të vitit shkollor dhe një takim në mbyllje të vitit shkollor.

Nr	Veprimtarite	Afati	Personat pergjegjes	Burimet	Bashkepunimet
1	Ngritja e Komisionit te Menaxhimit te Emergjencave	Shtator	Drejtoria	Dispozitat Normative	

2	Hartimi i planit vjetor	Tetor	Drejtoria, Komisioni i Menaxhimit të Emergjencave	Burime njerëzore brenda shkollës	
3	Vlerësimi i vulnerabilitetit	Nentor	Drejtoria, Komisioni i Menaxhimit të Emergjencave	Burime njerëzore dhe Burime proceduriale	Inxhinierja pranë DAR Berat, Inspektori pranë Drejtorisë së Arsimit Bashkia Berat
4	Shpërndarje e materialeve të ndryshme që kanë lidhje me sigurinë. Ndërgjegjësimi i nxënësve, prindërve dhe mëuesve rreth procedurave standarde në rast fatkeqësie	Dhjetor	Psikologe- Infermiere e shkollës Komisioni-	Videoprojektorë Material word, Fletëpalosje	Përfaqësues nga komisioni i menaxhimit të emergjencave
5	Trajnim i një grupi mësuesish për MKZ dhe demonstrim i veprimeve në rast zjarri	Janar	Drejtoria	Pajisjet për mbrojtjen kundër zjarrit	Punonjës të Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi SHMZSH

6	Rreth veprimtarisë me nxënës “Edukimi për menaxhimin e emergjencave dhe sigurinë në shkollë”	Shkurt	Psikologe A.Ismaili	Mjetet: Manuali “Edukimi për menaxhimin e emergjencave dhe sigurinë në shkollë”, udhëzues për shkollat 9-vjeçare, IZHA dhe UNICEF.	Nxenes te klasave te 6, 7 , 8 dhe 9
7	Biseda me persona nga komuniteti qe të ndajnë një eksperiencë personale me fëmijët lidhur me një çështje të caktuar për sigurinë. Theksohet rëndësia e ndjekjes së rregullave apo zbatimit të masave mbojtëse për një rrezik të caktuar si zjarri, drejtimi i makinës, ecja në rrugë të vështira, përmytja etj.	Mars	Drejtoria		Persona te komunitetit
8	Simulim me nxënësit dhe stafin për zbatimin e procedurave	Prill	Mesuesit: kujdestar ;te		

	standarde të veprimit në rast emergjencash dhe fatkeqësish të ndryshme nga mjedisi shkollë		edukimit fizik dhe nxenesit e shkolles		
9	Përgatitje e posterave në shkollë me tematikën e sigurisë	Maj	Nxënësit, Senati	Kartona, lapustila, lapsa, ngjyra	Mesuesit kujdestar
10	Shkrim i lirë në formën e Esesë mbi çështjet e sigurisë	Qershor	Nxënësit, Senati		Mesuesit kujdestar

FOTO TË VEPRIMTARIVE TË SHKOLLAVE














Veprimtari në rast tërmeti

<p>1. Momenti i parë i lëkundjes.</p> <p>• Që shpejt në pozicion për tërmet përkulu, mbuloju dhe prit.</p>	<p>2. Tërmeti ndalon.</p> <p>• Evakuoni ndërtesën.</p>	
<p><u>• Në klasë</u></p> <ul style="list-style-type: none"> • Personi që është afër derës duhet ta hapë atë personalisht. • Përkuluni në gjunjë dhe mbulohuni. Sa më shumë të jetë e mundur. • Mbuloju kokën, qafën dhe fytyrën. • Futuni poshtë që tavolinë nëse kemi afër një të tillë. • Mbahuni fort te tavolina ose mbulesa në të cilën jeni futur. • Qëndro larg mobilieve të rënda. • Kini kujdes për dorimin e shkollës. • Shpesh objektet janë pak rezistente mund të dëmtohen. 	<p><u>• Në laborator</u></p> <p>• Largoni materialet e rrezikshme që mund të marrin zjarr, para se të futeni poshtë tavolinës.</p> <div style="text-align: center;">  </div>	<p><u>• Jashtë në sipërfaqe të hapur</u></p> <ul style="list-style-type: none"> • Nëse gjatë tërmetit gjendeni jashtë, qëndroni larg mureve që mund të shemben, pemëve dhe shtyllave elektrike. • Përkuluni, mbuloju dhe prisni duke mbrojtur me krahët tuaj kokën dhe qafën. • Në rast se ndodheni në autobus ose në furgonin e shkollës, shoferi duhet të ndalojë mjetin larg zonës të rrezikut.



MENAXHIMI I EMERGJENCAVE DHE SIGURISE NE SHKOLLE

Synimi :

- Reduktimi e rrezikut të fatkeqesive dhe emergjencave të cilat shpesh vrasin në shkollë.
- Shprehja e shqetësimit dhe shprehja e shqetësimit të gjeneralit nëse rreziku është i pranueshëm.

Objektivat :

- Reduktimi dhe eliminimi i rrezikut të fatkeqesive dhe emergjencave të cilat shpesh vrasin në shkollë.
- Reduktimi i rrezikut të fatkeqesive dhe emergjencave të cilat shpesh vrasin në shkollë.
- Reduktimi i rrezikut të fatkeqesive dhe emergjencave të cilat shpesh vrasin në shkollë.
- Reduktimi i rrezikut të fatkeqesive dhe emergjencave të cilat shpesh vrasin në shkollë.
- Reduktimi i rrezikut të fatkeqesive dhe emergjencave të cilat shpesh vrasin në shkollë.
- Reduktimi i rrezikut të fatkeqesive dhe emergjencave të cilat shpesh vrasin në shkollë.
- Reduktimi i rrezikut të fatkeqesive dhe emergjencave të cilat shpesh vrasin në shkollë.
- Reduktimi i rrezikut të fatkeqesive dhe emergjencave të cilat shpesh vrasin në shkollë.
- Reduktimi i rrezikut të fatkeqesive dhe emergjencave të cilat shpesh vrasin në shkollë.
- Reduktimi i rrezikut të fatkeqesive dhe emergjencave të cilat shpesh vrasin në shkollë.

Plani vjetore :

№	Emri i veprimtarisë	Orari	Personat përfshirë
1
2
3
4
5
6
7
8
9
10
11
12
13
14
15
16
17
18
19
20
21
22
23
24
25
26
27
28
29
30

№	Emri i veprimtarisë	Orari	Personat përfshirë
1
2
3
4
5
6
7
8
9
10
11
12
13
14
15
16
17
18
19
20
21
22
23
24
25
26
27
28
29
30



№	Emri i veprimtarisë	Orari	Personat përfshirë
1
2
3
4
5
6
7
8
9
10
11
12
13
14
15
16
17
18
19
20
21
22
23
24
25
26
27
28
29
30

VEPRIMTARITE

